




International
Labour
Organization



VLERËSIMI I NDIKIMIT TË COVID-19 NË STATUSIN SOCIO-EKONOMIK TË KOMUNITETEVE ROM, ASHKALI DHE EGJIPTIAN NË KOSOVË



Financuar nga:

Në bashkëpunim me:

 Austrian
Development
Cooperation



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale
Ministarstvo Rada i Socijalne Zaštite
Ministry of Labour and Social Welfare



AGJENCIA E PUNËSIMIT E REPUBLIKËS SË KOSOVËS
AGENCIJA ZA ZAPOSŁJAVANJE REPUBLIKE KOSOVA
EMPLOYMENT AGENCY OF THE REPUBLIC OF KOSOVO

HULUMTIMI I KRYER NGA:



D&D BUSINESS SUPPORT CENTER

Sheshi "Edit Durham", H1, Nr.11,

10000 Prishtinë, Republika e Kosovës

Tel: +383 (0) 38 748 701, +383 (0) 44 693 564

E-mail: info@dd-bsc.com

Web: www.dd-bsc.com

FINANCUAR NGA:



NË BASHKËPUNIM ME:



International
Labour
Organization

PARTNER:



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale
Ministarstvo Rada i Socijalne Zaštite
Ministry of Labour and Social Welfare



AGJENCIA E PUNËSIMIT E REPUBLIKËS SË KOSOVËS
AGENCIJA ZA ZAPOŠLJAVANJE REPUBLIKE KOSOVA
EMPLOYMENT AGENCY OF THE REPUBLIC OF KOSOVO

EKIPI I PROJEKTIT:

Safet Fazliu
Skender Fejzullahu
Bujar Berisha
Drilon Shala
Egzon Fejzullahu
Xhyljetë Luzha

Vërejtje : Përgjegjësia për mendimet e shprehura, studimet dhe kontributet e tjera bie vetëm tek autorët e tyre dhe botimi nuk përbën një miratim nga Zyra Ndërkombëtare e Punës e pikëpamjeve të shprehura në të.

Përmbajtja

1. Përmbledhje ekzekutive	6
2. Hyrje.....	8
2. 1. Historiku i projektit	8
2. 2. Metodologjia	9
2.2.1. Anketa	9
2.2.2. Shpërndarja e mostrës	9
3. Gjetjet e hulumtimit	12
3.1. Demografia.....	12
3.2. Burimet e të hyrave	14
3.3. Punësimi dhe jetesa – Indikatorët e tregut të punës.....	15
Të punësuarit.....	17
Të vetë punësuarit.....	18
Të papunët	19
Mbështetja nga Zyra e Punësimit.....	23
3.4. Edukimi.....	26
3.5. Ndikimi i COVID-19 në statusin socio-ekonomik të komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian. 29	
3.5.1. Ndikimi i pandemisë në aktivitetin social.....	29
3.5.2. Ndikimi i pandemisë në aktivitetin ekonomik	30
3.5.3. Qasja në shërbimet shëndetësore	36
3.5.4. Ndikimi psikik nga pandemia	37
3.5.5. Rastet e infektimit me COVID-19	40
3.5.6. Përballimi financiar i COVID-19.....	41
4. Konkluzione	42
5. Rekomandime	44
Bibliografia	45
Shtojca A – Numri i romëve, ashkalive dhe egjiptianëve sipas komunave.....	46
Shtojca B – Numri i romëve, ashkalive dhe egjiptianëve të anketuar sipas komunave	47
Shtojca C – Forma e pyetësorit	48

SHKURTESAT

APRK	Agjencia e Punësimit e Republikës së Kosovës
AFP	Anketa e Fuqisë Punëtore
BE	Bashkimi Evropian
BB	Banka Botërore
EET	Të rinj që janë të punësuar, ndjekin shkollën apo trajnim
ILO	Organizata Ndërkombëtare e Punës
MAShT	Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë
MATP	Masat Aktive të Tregut të Punës
MF ose MFT	Ministria e Financave dhe Transfereve
MPMS	Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale
NEET	Të rinj që nuk janë të punësuar, nuk ndjekin shkollën apo trajnim
QAP	Qendra e Aftësimit Profesional
QK	Qeveria e Kosovës
QKUK	Qendra Klinike Universitare e Kosovës
RZHN	Raporti i Zhvillimit Njerëzor
SIMP	Sistemi Informativ për Menaxhimin e Punësimit
UNDP	Programi për Zhvillim i Kombeve të Bashkuara
ZP	Zyra (Komunale) e Punësimit

LISTA E TABELAVE

- Tabela 1.1. Shpërndarja e mostrës sipas përkatësisë etnike
Tabela 1.2. Shpërndarja e mostrës sipas gjinisë
Tabela 1.3. Shpërndarja e mostrës sipas grup moshës
Tabela 1.4. Shpërndarja e mostrës sipas komunave
Tabela 2. Vlera e të hyrave mujore
Tabela 3. Të dhënat e statusit të punësimit bazuar në gjininë, vendbanimin dhe arsimin
Tabela 3.1. Të dhënat e të punësuarve me kohë të plotë bazuar në gjininë, vendbanimin dhe arsimin
Tabela 3.3.3. Të papunë afatgjatë (më shumë se 12 muaj). Të dhëna bazuar në gjininë, vendbanimin dhe arsimin
Tabela 3.4. Të dhëna krahasuese nga SIMP, APRK rreth regjistrimit si punëkërkues dhe ndërmjetësimit për punë të rregullt
Tabela 4.1.1. Niveli i arsimit formal bazuar në gjininë dhe vendbanimin
Tabela 4.2.1. Kursantët bazuar në Ofruesit, Gjininë dhe Statusin e Punësimit

LISTA E FIGURAVE

- Figura 1.1. Gjinia e të anketuarve
Figura 1.2. Moshë e të anketuarve
Figura 1.3. Numri i të anketuarve sipas komunave
Figura 1.4. Etnia e të anketuarve
Figura 1.5. Vendbanimi i të anketuarve
Figura 1.6. Numri i anëtarëve të familjes
Figura 2. Burimet e të hyrave
Figura 3. Statusi i punësimit
Figura 3.1. Lloji i punësimit
Figura 3.1.1. Sektori i punësimit
Figura 3.2.1. Sektori apo profesioni i vet-punësimit
Figura 3.2.2. Lloji i vet-punësimit
Figura 3.3.1. Regjistrimi në APRK si të papunë
Figura 3.3.2. Periudha e regjistrimit
Figura 3.3.3. Statusi i papunësisë
Figura 3.3.4. Interesimi për punë
Figura 3.3.5. Aplikimet për punësim
Figura 3.3.6. Format e kërkimit për punë
Figura 3.3.7. Format e aplikimit për punë
Figura 3.3.8. Vetëbesimi në fazat e aplikimit për punë
Figura 3.4. Mbështetja nga Zyra e Punësimit - ZP
Figura 3.4.1. Numri i përfituesve të masave aktive të tregut të punës nga ZP-të e APRK-së
Figura 3.4.2. Perceptimi i Masave Aktive të Tregut të Punës nga ZP-të
Figura 4.1.1. Niveli i edukimit formal
Figura 4.1.2. Niveli më i lartë i edukimit formal të familjarëve
Figura 4.2.1. Ndjekja e trajnimeve profesionale
Figura 4.2.2. Ofruesit e trajnimeve
Figura 4.2.3. Fushat e trajnimeve
Figura 4.3.1. Planifikimi për vazhdimin e edukimit
Figura 4.3.2. Forma e vazhdimin të edukimit
Figura 5.1. Ndikimi i pandemisë në aktivitetin social
Figura 5.2.1.1. Ndikimi i pandemisë në punë
Figura 5.2.1.2. Format e marrjes së pagës
Figura 5.2.1.3. Ndikimi i pandemisë në rrogë
Figura 5.2.1.4. Përfitimi nga Masat për punëtorë nga Pako Emergjente Financiare e Q.K.
Figura 5.2.2.1. Numri i përfituesve të asistencës sociale, dhe llojet e saj
Figura 5.2.2.2. Përfitimi nga Masat për të papunët nga Pako Emergjente Financiare e Q.K.

Figura 5.2.3.1. Operimi i ndërmarrjes si pasojë e pandemisë
Figura 5.2.3.2. Përfitimi nga Masat për ndërmarrjet nga Pako Emergjente Financiare
Figura 5.2.4. Obligimet mujore financiare
Figura 5.2.5.1. Përfitimet me pako
Figura 5.2.5.2. Llojet e pakove
Figura 5.2.5.3. Shpërndarësit/financuesit e pakove
Figura 5.3.1. Lloji i shërbimeve shëndetësore
Figura 5.3.2. Nevoja për shërbime shëndetësore
Figura 5.3.3. Vlerësimi i qasshmërisë dhe performancës së shërbimeve shëndetësore
Figura 5.4.1. Ndikimi i pandemisë në nivelin e stresit
Figura 5.4.2. Ndikimi i limitimit të aktiviteteve
Figura 5.4.3. Ndikimi i pandemisë në acarime të marrëdhënieve familjare
Figura 5.4.4. Ndikimi i karantinës në acarime të marrëdhënieve familjare
Figura 5.4.5. Raste të dhunës në familje
Figura 5.4.6. Përhapja e kësaj dukurie në komunitetin tuaj
Figura 5.4.7. Ku duhet të raportohet dhuna
Figura 5.5.1. Infektimet me COVID-19
Figura 5.5.2. Trajtimi i tyre
Figura 5.6. Përballimi i kësaj gjendje financiarisht

1. Përmbledhje ekzekutive

Tanimë, përhapja e pandemisë COVID-19 ka prekur të gjitha shtresat e njerëzve, bizneseve dhe mënyrat e të jetuarit dhe punuarit në gjithë botën. Sektorë të tërë janë pothuajse jashtë funksionimit si pasojë e masave parandaluese të ndërmarra, apo si pasojë e zvogëlimit të kërkesës agregate për ato produkte/shërbime. Pothuajse e gjithë ekosistemi i biznesit është ndikuar negativisht, duke përjashtuar sektorët esencial. Ky trend, ndikon drejtpërsëdrejti tek mirëqenia e qytetarëve, sidomos tek vendet e pazhvilluara si dhe tek grupet/komunitetet e marginalizuara ku ndihet tej mase mungesa e ndërhyrjes institucionale në mënyrë efektive.

Përkundër që është duke u bërë një vit prej se ky virus ka shkaktuar pandemi, me dhjetëra miliona të infektuar, dhe afër 2.5 milion të vdekur si pasojë e tij, tanimë diskursi dhe politikat janë paralelisht në dy drejtime: shëndetësore dhe ekonomike. Hulumtimet dhe zhvillimet intensive në drejtim të ardhjes me një vaksinë efektive dhe gjetja e masave të mbrojtjes nga ky virus pa ndikuar në shëndetin ekonomik janë preokupimet e të gjitha vendeve tash e disa muaj.

Institucionet e Kosovës kanë marrë një seri masash me qëllim të parandalimit të shpërndarjes së këtij virusi, në periudha të ndryshme që nga Marsi 2020, duke përfshirë izolimin e vatrave të virusit, mbylljen e kufijve, kufizimin e lëvizjeve në kohë të caktuara, ndalimin e grumbullimeve dhe ndalimin e operimeve të pothuajse të gjitha aktiviteteve biznesi. Përkritazi me këto masa të ndërmarra, me qëllim të ruajtjes së shëndetit ekonomik gjithashtu, këto institucione kanë ndërmarrë edhe një sërë masash financiare në mbështetje të bizneseve / punëtorëve dhe grupeve më gjendje ekonomike të dobët apo në varfëri të skajshme. Duke e parë zgjatjen e ndikimit të kësaj pandemie dhe kapacitetin buxhetor që ka Kosova, bazuar në nevojat dhe kërkesat, ato masa janë shumë modeste dhe në shumë raste të vonuara apo që për arsye të procedurave formale / teknike rreth aplikimeve tek këto masa, shumë qytetarë nuk kanë pasur mundësi të përfitojnë nga to. Si grupe më të theksuara që edhe ky hulumtim dëshmon se nuk kanë përfituar sa duhet, janë edhe komunitetet jo-shumicë, e me theks të veçantë komunitetet rom, ashkali dhe egjiptianë.

Organizata Ndërkombëtare e Punës (ILO) ka vendosur të mbështesë këtë hulumtim në mënyrë që të vlerësojë në detaje ndikimin socio-ekonomik të pandemisë në këto komunitete, një mbështetje e cila do të kontribuonte dhe do të mundësonte Agjencinë e Punësimit të Republikës së Kosovës - EARK dhe të aktorët e tjerë të rëndësishëm zyrtarë qeveritarë dhe vendimmarrës për të rritur efikasitetin dhe efektivitetin e strategjive që synojnë këto komunitete dhe mbështesin integrimin e tyre në tregun e punës. Disa nga të gjeturat kryesore të këtij hulumtimi si punësimi, burimet e të hyrave, niveli i edukimit, qasja në shërbime shëndetësore, përballja financiare, sociale dhe shëndetësore me pandeminë dhe përfitimi i masave aktive të tregut të punës si dhe ato të pakos emergjente financiare janë të prezantuara në këtë raport.

Ky hulumtim, tregon se ndikimi i pandemisë, i cili është duke u përshkallëzuar edhe më shumë, tek këto komunitete edhe pse është në proporcion të njëjtë me të gjitha komunitetet tjera vlerësohet që të ketë pasojë shumëfish më të mëdha duke e pasur bazën ekonomike dhe sociale më të ulët.

Gjetjet nga ky hulumtim kanë treguar se gjetje të ngjashme janë për të tre komunitetet dhe për të gjitha komunat. Sidoqoftë, dallime të konsiderueshme u vunë re kur krahasoheshin midis gjinisë dhe vendit të jetesës (vendndodhje të tilla si: rurale, gjysmë-urbane dhe urbane), ku gratë dhe ato që jetojnë në zonat rurale dhe gjysmë-urbane janë më të pa favorizuara për shkak të detyrimeve familjare të moshës së hershme, përkatësisht për shkak të mungesës së mundësive në ato zona, dhe në përgjithësi për shkak të nivelit më të lartë të diskriminimit.

Hulumtimi tregon se 62% e tyre janë të papunë, 9% prej të cilëve janë të papunë si pasojë e pandemisë. Vetëm 8% janë të punësuar, dhe 30% e tyre janë të vetëpunësuar (punë / shërbim jo i rregullt apo ditor i ofruar sipas kërkesës) nga të cilët shumica (95% e të vetë punësuarve) janë në sektorin e

ekonomisë jo formale. Puna apo vetë punësimi që ata e kanë, hyn kryesisht në sektorin e punëve fizike (ndërtimtari, mirëmbajtje, apo grumbullues të metaleve dhe elementeve të tjera).

Familjet e komuniteteve rome, ashkali dhe egjiptiane jetojnë me mesatarisht 167 Euro në muaj, apo 23.85 Euro në muaj për anëtar të familjes ose 0.79 Euro në ditë për anëtar të familjes. Këto shifra nënkuptojnë se ata jetojnë nën kufirin e varfërisë, edhe kur krahasohen me standardin e jetesës vetëm të Kosovës.

Vetëm 40% e numrit total të anketuarve të papunë janë të regjistruar si të papunë në Zyrat e Punësimit (APRK). Numri i të regjistruarve si të papunë apo punëkërkues është rritur për 20% gjatë pandemisë, ndërsa për tërë popullatën e Kosovës numri i punëkërkuesve të regjistruar është trefishuar bazuar në të dhënat e EARK krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar.

Mungesa e eksperiencës dhe e shkathtësive në hulumtimin dhe aplikimin për punë, si dhe ndjenja e tyre si të pabarabartë vlerësohen të jenë arsye kryesore se shumë prej tyre edhe kanë humbur interesimin apo shpresën për të gjetur një vend pune.

Mësimi online gjatë vitit të kaluar shkollor e ka bërë të pamundur për ata që të ndjekin mësimet në këtë formë për shkak të mungesës së pajisjeve teknologjike dhe qasjes në internet edhe pse Kosova ka mbulimin më të lartë të Internetit me shumë Ofrues të Shërbimeve të Internetit.

Nga të gjitha masat nga pako emergjente financiare, numri i përfituesve të këtyre komuniteteve është shumë i vogël në krahasim me mesataren e komuniteteve tjera në Kosovë. Të njëjtat të gjetura janë edhe për Masat Aktive të Tregut të Punës – MATP-të nga APRK.

Hulumtimi tregon se pandemia dhe karantina ka ndikuar në shëndetin emocional, mental dhe në atë fizik. Përderisa kur është fjala tek acarimet dhe dhuna në familje si pasojë e pandemisë, vetëm një numër i vogël (13%) raportojnë acarimet dhe dhunën, mirëpo ka raste të shumta të acarimeve familjare që qojnë edhe në dhunë e cila në të shumtën e rasteve nuk raportohet.

Hulumtimi nxjerrë se 62% e këtyre komuniteteve mendojnë se nuk do mund ta përballojnë financiarisht më shumë se 1 muaj këtë gjendje të pandemisë, dhe 33% e tyre vlerësojnë se nuk mund ta përballojnë më shumë se 2 muaj.

Shumica e këtyre komuniteteve nuk kishin ndonjë sugjerim konkret për APRK-në (MPMS-së). Prioritet për ta janë punësimi i qëndrueshëm, rritja e ndihmës sociale dhe ushqimi.

Në bazë të qëllimit dhe analizës së këtij hulumtimi të përbërë edhe nga hulumtime tjera sekondare dhe diskutime me institucione relevante dhe përfaqësues të organizatave të këtyre komuniteteve, ky raport ka ndarë rekomandimet në dy grupe: rekomandimet urgjente në lidhje me pandeminë, dhe rekomandimet në lidhje me mbështetjen e këtyre komuniteteve në integrimin në tregun e punës.

2. Hyrje

2. 1. Historiku i projektit

Pandemia COVID-19 është shumë më tepër sesa vetëm një krizë shëndetësore. Në shkallë globale pandemia po prek edhe shoqëritë dhe ekonomitë më të zhvilluara. Përderisa madhësia e ndikimit të pandemisë ndryshon nga vendi në vend dhe politikat që ata vendosin për ta zbutur atë, sigurisht se kjo do të rrisë varfërinë dhe pabarazitë socio-ekonomike në të gjithë globin. Mungesa e reagimit të duhur nga institucionet përkatëse, në kohë dhe efektiv, do përkeqësoj dhe do të vërë në rrezik të lartë jetë të shumta dhe mënyrën e jetesës për vitet që vijnë.

Aktualisht, Kosova është në atë që quhet “vala e dytë” e COVID-19. Me qindra raste të reja infeksioni paraqiten çdo ditë, duke marrë parasysh numrin dhe strukturën e popullsisë së Kosovës dhe moshën e re mesatare të saj, këto shifra janë dukshëm të larta. Duke pasur mesatarisht nga dhjetë përfundime fatale – raste të vdekjes në baza ditore, gjë që kur krahasohet me vendet e tjera në rajon, e vendos Kosovën në krye të listës si një nga vendet me numrin më të lartë të njerëzve që vdesin për shkak të COVID-19 në proporcion me numrin e popullsisë. Ky është një numër tejet i lartë që rezulton edhe nga sistemi i dobët shëndetësor në vend.

Derisa numrat e të infektuarve është akoma në rritje, qeveria e Kosovës ka reaguar me një sërë masash kufizuese që prekin një numër të madh sektorësh biznesi me theks në gastronominë dhe sektorët e shërbimeve në përgjithësi, përfshirë ndalimin e grumbullimeve dhe kufizimet e lëvizjeve të lira në orë dhe ditë të caktuara. Kjo po godet rëndë ekonominë tashmë të brishtë të Kosovës dhe reagimi i shpejtë është esencial përmes pakove emergjente financiare dhe të rimëkëmbjes socio-ekonomike të sinkronizuara me masat e tjera parandaluese në kontekstin shëndetësor.

Për derisa, vendet e tjera tashmë kanë vendosur dhe shpërndarë pakot financiare të treta dhe në disa raste të katërta në lidhje me zbutjen e ndikimit të COVID-19 në kontekstin socio-ekonomik; aktualisht, qeveria e Kosovës ende nuk e ka kaluar për miratim pakon e saj financiare të rimëkëmbjes ekonomike në Parlamentin e Kosovës për shkak të mungesës së konsensusit të partive politike përkundër përpjekjeve të qeverisë për ta bërë atë për muaj me radhë. Deri më tani, ka qenë vetëm një pako emergjente financiare e krijuar nga qeveria e Kosovës që nga fillimi i pandemisë nga e cila ende nuk janë kompletuar / disbursuar të gjitha masat e saj për shkak të pengesave legislative fiskale.

Me të vërtetë, COVID-19 ka ndikuar negativisht në të gjitha vendet dhe njerëzit në shumë dimensionë, si: shëndetësore, sociale dhe ekonomike. Sidoqoftë, vendet më pak të zhvilluara siç është rasti me Kosovën, dhe grupet në varfëri të skajshme, të papunët, të punësuarit në ekonominë jo formale, pakicat dhe grupet e tjera të marginalizuara, pa dyshim, janë prekur më së shumti.

Një nga grupet më të prekura janë komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian të cilët jetojnë në Kosovë, ku shumica e tyre jetojnë në varfëri, janë të papunë ose të (vet)punësuar në sektorin informal; siç shtjellon më tej ky hulumtim.

Varësia e tyre nga mbështetja e të tjerëve (remitancat nga të afërmit / anëtarët e familjes) është e limituar tani duke pësuar të gjithë rënie të hyrave për shkak të trendit negativ ekonomik në mbarë botën. Duke shtuar këtu faktin që meqenëse shumica e tyre punojnë në sektorin informal – ata janë pothuajse të përjashtuar nga ndihma financiare gjë që në krahasim me punëtorët e sektorit formal ua vështirëson tej mase atyre përballjen me këtë situatë pandemike që nuk dihet se kur do të përfundojë.

Ky hulumtim është i mbështetur nga Organizata Ndërkombëtare e Punës - ILO, në kuadër të projektit “Promovimi i Zgjidhjeve Përfshirëse të Tregut të Punës në Ballkanin Perëndimor” financuar nga Agjencia Austriake e Zhvillimit. Hulumtimi ka për qëllim ofrimin e një vlerësimi të detajuar të ndikimit socio-ekonomik të COVID-19 tek këto komunitete, kontribuon dhe i mundëson Agjencisë së Punësimit të Republikës së Kosovës – APRK-së dhe akterëve tjerë relevant në rritjen e efikasitetit dhe

efektivitetin e strategjive që synojnë këto komunitete dhe mbështesin integrimin e tyre në tregun e punës.

2.2. Metodologjia

Në mënyrë që të vlerësohet ndikimi i COVID-19 në statusin socio-ekonomik të komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian në Kosovë, Organizata Ndërkombëtare e Punës - ILO ka kontraktuar kompaninë konsulente D&D Business Support Center për të realizuar këtë hulumtim me një mostër prej 1,155 të anketuarëve, pasuar nga intervistat dhe diskutimet me përfaqësuesit e komuniteteve të synuara dhe palët tjera.

2.2.1. Anketa

Për qëllimet e këtij studimi, mbledhja e të dhënave për studimin u krye përmes metodës CAPI (Intervistim Personal i Ndihmuar nga Kompjuter). Sistemi ynë ka përdorur komunat e zgjedhura si hapin e parë të përzgjedhjes së të anketuarve. Në momentin që intervistuesit tanë në terren kanë takuar një qytetar me përkatësi etnike rome, ashkali ose egjiptiane, një pyetësor shqyrtimi është përdorur për të përcaktuar nëse i anketuari është i përshtatshëm për kërkesat e mostrës, si:

- Etnia;
- Gjinia;
- Mosha; dhe
- Lokacioni/komuna.

Në momentin që kriteret janë përmbushur, atëherë është zhvilluar intervista. Hulumtimi në terren - intervistat janë kryer nga 12 tetori deri më 4 nëntor 2020.

2.2.2. Shpërndarja e mostrës

Shpërndarja e mostrës për analizën është bazuar në të dhënat zyrtare nga Agjencia e Statistikave të Kosovës¹. Në tabelat vijuese janë paraqitur përqindja e popullsisë ndërmjet komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian në Kosovë, për sa i përket moshës, (15-64 vjeç), gjinisë dhe komunave bazuar në të dhënat e regjistrimit të vitit 2011, siç tregohet në tabelat më poshtë. Bazuar në këto të dhëna, intervistat janë zgjedhur përmes katër elementeve demografike:

- a) Etnia: rom, ashkali dhe egjiptian;
- b) Gjinia;
- c) Grup moshat: nga 15 në 64 vjeç, të ndara në tre (3) grup mosha për një përfaqësim efektiv të mostrës; dhe
- d) Vendndodhja / Komuna: në ato lokacione / komuna ku ka më shumë se 500 banorë të këtyre komuniteteve.

Kjo metodologji e mostrës na ka lejuar të kemi një përfaqësim efektiv për hulumtimin në terren. Për më shumë detaje për secilën prej elementeve demografike të zgjedhura, ju lutem shikoni tabelat dhe qasjen e propozuar, më poshtë.

¹ Kosovo Agency of Statistics (2013); "Estimation of Kosovo Population 2011", Office of the Prime Minister, Pristina.

Tabela 1.1. Shpërndarja e mostrës sipas përkatësisë etnike

Struktura e popullsisë sipas përkatësisë etnike			
Etnia	Nr. i përgjithshëm i popullsisë së këtyre komuniteteve në Kosovë	Përqindja sipas përkatësisë etnike	Mostra etnike
Rom	8,824	25%	385
Ashkali	15,436	43%	385
Egjiptian	11,524	32%	385
Total	35,784	100%	1,155

Siç ilustron në tabelën 1.1., janë mbi 35 mijë (2.1% e popullsisë totale) rom, ashkali dhe egjiptian që jetojnë në Kosovë, të shpërndarë në përqindjet vijuese: rom 25% (0.5% e popullsisë totale), ashkali 43% (0.9% e popullsisë totale) dhe egjiptian 32% (0.7% e popullsisë totale). Përfshirja e barabartë e të anketuarve në këtë hulumtim ishte për shkak të përfaqësimit dhe krahasimit më të mirë të mostrës për secilin nën-grup (etni).

Tabela 1.2. Shpërndarja e mostrës sipas gjinisë

Struktura e popullsisë sipas gjinisë			
Gjinia	Popullsia totale në Kosovë sipas gjinisë	Përqindja e popullsisë së përgjithshme të Kosovës sipas gjinisë	Mostra gjinore
Mashkull	875,900	50.34%	581
Femër	863,925	49.66%	574
Total	1,739,825	100.00%	1,155

Për shkak të të dhënave të kufizuara në lidhje me strukturën gjinore të popullsisë për secilin prej komuniteteve specifike të synuara për këtë hulumtim në terren, ne iu kemi referuar strukturës së përgjithshme të popullsisë së Kosovës sipas gjinisë, e cila është pothuajse e barabartë ndërmjet komuniteteve.

Tabela 1.3. Shpërndarja e mostrës sipas grup moshës

Grup moshë	Rom	Ashkali	Egjiptian	Total sipas grup moshës	% sipas grup moshës	Mostra sipas grup moshës
15-29	2,288	4,155	3,186	9,629	46%	531
30-49	1,923	3,389	2,600	7,912	38%	439
50-64	890	1,336	1,131	3,357	16%	185
Total	5,101	8,880	6,917	20,898	100%	1,155

Siç ilustron në tabelën 1.3., janë afër 21 mijë rom, ashkali dhe egjiptian brenda tre grupeve tona të moshës. Tabela, më tej ndahet në secilin grup moshë në formën e përqindjes. Përfshirja e të anketuarve në këtë hulumtim është bazuar në këtë proporcion, përkatësisht në strukturën e mësipërme të popullsisë.

Tabela 1.4. Shpërndarja e mostrës sipas komunave²

Nr.	Komuna	Totali i komuniteteve sipas komunave	% sipas përkatësisë etnike	Mostra sipas komunave
1	Gjakovë	6,468	18.88%	218
2	Prizren	4,417	12.90%	149
3	Fushë Kosovë	3,948	11.53%	133
4	Ferizaj	3,857	11.26%	130
5	Pejë	3,836	11.20%	129
6	Lipjan	2,158	6.30%	73
7	Istog	1,694	4.95%	57
8	Obiliq	1,266	3.70%	43
9	Mitrovicë	1,181	3.45%	40
10	Klinë	1,097	3.20%	37
11	Graçanicë	852	2.49%	29
12	Rahovec	787	2.30%	27
13	Shtime	773	2.26%	26
14	Podujevë	756	2.21%	25
15	Prishtinë	621	1.81%	21
16	Suharekë	539	1.57%	18
Total		34,250	100.00%	1,155

Përzgjedhja e Komunave ka qenë në përputhje me dendësinë më të madhe të popullsisë nga të tre komunitetet (rom, ashkali dhe egjiptian) sipas të dhënave të regjistrimit 2011. Ne kemi zgjedhur komuna që kanë më shumë se 500 banorë të komuniteteve të synuara, gjë që rezultojnë të jenë gjashtëmbëdhjetë (16) komuna me mbi 34 mijë banorë.

Pra, nga popullata e përgjithshme e komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian që jetojnë në Kosovë, duke u bazuar nga elementet demografike si: grup mosha, komuna dhe gjinia - popullsia që plotëson kriteret për hulumtim është afër 21 mijë rom, ashkali dhe egjiptian brenda 16 komunave dhe tre (3) grup moshave të zgjedhura.

Nga ky numër, mostra prej 1,155 të anketuarve na ka mundësuar që të kemi një përfaqësim dukshëm të lartë dhe raport me gjetje koncize të hulumtimit në terren.

² Shtojca B, ilustron numrin e të anketuarve për secilin komunitet veç e veç sipas komunave

3. Gjetjet e hulumtimit

Me qëllim të analizimit, krahasimit dhe vërtetimit të të dhënave dhe nxjerrjen e rekomandimeve nga të gjeturat për nevoja të zhvillimit të politikave nga EARK, në funksion të mbështetjes dhe integritetit të këtyre komuniteteve në tregun e punës dhe përmirësimit të gjendjes sociale të tyre, gjetjet e pasqyruara në këtë raport përfshijnë hulumtime në terren, hulumtime në tryezë dhe diskutime në grupe me palët e interesit (përfaqësuesit e këtyre komuniteteve dhe EARK).

Gjetjet e hulumtimit primar u gjeneruan përmes një pyetësori i cili është përdorë për intervista ballë për ballë, me një mostër prej total 1,155 rom, ashkali dhe egjiptian të anketuar.

3.1. Demografia

Në aspektin demografik, ky hulumtim ka një pjesëmarrje pothuajse të barabartë sa i përket përfaqësimit gjinor. Në lidhje me strukturën e moshës së popullsisë, 46% e të anketuarve hyjnë në kategorinë e moshës prej 15-29 vjet, e cila pasohet me 38% në kategorinë e moshës prej 30-49 vjet, dhe me 16% në kategorinë 50-64 vjet. Moshë mesatare e të anketuarve është 40 vjeçare.

Figura 1.1. Gjinia e të anketuarve





Figura 1.2. Moshë e të anketuarve




Duke iu referuar shpërndarjes gjeografike të mostrës, ajo është marrë nga ato komuna ku jetojnë 500 e më shumë banorë të komuniteteve në fjalë. Bazuar në të dhënat nga regjistrimi i fundit i popullsisë nga Agjencia e Statistikave të Kosovës – ASK³, janë përzgjedhur 16 komunat që përmbushin këtë kriter, ku prin me numrin më të madh të të anketuarve komuna e Gjakovës, e cila pasohet me ato të Prizrenit, Fushë Kosovës, Ferizajit, Pejës e më tutje, siç është e pasqyruar në figurën 1.3.

Numri specifik i të anketuarve për secilën komunë është në proporcion me numrin total të banorëve këtyre komuniteteve, dhe të gjitha këto 16 komunat të përzgjedhura përbëjnë 97% të këtyre komuniteteve që jetojnë në Kosovë. Në shumë prej komunave tjera të Kosovës të pa përfshira në këtë hulumtim ka shumë pak komunitete rom, ashkali apo egjiptian dhe në shumë raste nuk ka fare banor të këtyre komuniteteve. Rrjedhimisht, kjo përzgjedhje gjeografike tek mostra e këtij hulumtimi është mjaftueshëm përfshirëse dhe reprezentative e komuniteteve të synuara në këtë hulumtim.

Figura 1.3. Numri i të anketuarve sipas komunave

³ Kosovo Agency of Statistics (2013); "Estimation of Kosovo Population 2011", Office of the Prime Minister, Pristina.



Duke e marrë parasysh se janë tri etni të ndryshme me numër jo të njëjtë, por të përafërt, si total i të tri këtyre komuniteteve të cilat përbëjnë rreth 2% të të gjithë popullsisë në Kosovë, struktura e këtyre komuniteteve (krahas totalit të tyre) në Kosovë është si vijon: rom 25%, ashkali 43%, dhe egjiptian 32%. Megjithatë për të arritur deri te një marzhë gabimi në (+/-)5% brenda secilit grup, dhe me qëllim krijimit dhe krahasimit të të dhënave në nivel të këtyre komuniteteve, mostra e këtij hulumtimi është e barabartë për të tri komunitetet duke anketuar 385 persona nga secili komunitet, siç edhe është pasqyruar tek figura 1.4.

Përveç kësaj, me qëllim të mundësisë së krahasimit sa më të detajuar, mostra është e përafërt edhe sa i përket vendbanimit të këtyre komuniteteve në urban, gjysmë urban, dhe rural siç mund të vërehet tek figura 1.5.

Figura 1.4. Etnia e të anketuarve






Figura 1.5. Vendbanimi i të anketuarve



Pjesë shumë e rëndësishme e hulumtimit demografik, sidomos për qëllime të këtij hulumtimi është edhe numri i anëtarëve të familjes për secilin të anketuar. Figura 1.6., pasqyron në formë grafike se këto komunitete kanë shumë anëtar të familjes. Mbi 90% e të anketuarve hyn në kategorinë ku kanë 4 deri në 10 anëtar të familjes, kryesisht shumë fëmijë apo jetesë në bashkësi familjare me mesatarisht 7 anëtar.

Figura 1.6. Numri i anëtarëve të familjes




3.2. Burimet e të hyrave

Në pyetjen se cilat janë burimet e të hyrave dhe në çfarë vlere arrijnë ato për muaj, lë të kuptohet gjendja e vështirë financiare me të cilën këto komunitete përballen çdo ditë, duke përfshirë edhe periudhën para pandemisë.

Nga të gjithë të anketuarit, vetëm afër 14% e tyre kanë më shumë se një burim (dy) të të hyrave në familje. Nëse analizohet mirë figura 2., vërejmë se 38% e tyre sigurojnë të hyrat nga puna, vetëpunësimi apo biznesi i tyre, dhe 35% e tyre janë të varur nga anëtarët e tjerë të familjes dhe të afërmit, ndërsa 40% e të anketuarve pranojnë asistencë sociale apo ndihmë tjetër nga shteti në baza mujore.

Figura 2. Burimet e të hyrave



Për të analizuar se sa është vlera e të hyrave të tyre mujore, është shtruar pyetja rreth shumës në Euro. Nga tabela 2., e ndarë në pesë (5) kategori, vërejmë se më shumë se gjysma (55.35%) e të anketuarve hynë në kategorinë e dytë, të cilët marrin ndërmjet 101 deri në 200 Euro (apo mesatarisht 155 Euro të hyra mujore në familje). Menjëherë pas kategorisë së dytë, vjen kategoria e parë me 23.46% të cilët marrin jo më shumë se 100 Euro në muaj (apo mesatarisht 90 Euro të hyra mujore në familje). Në kategorinë e tretë (201 – 300 Euro) bëjnë pjesë 18.78% e të anketuarve me një mesatare

prej rreth 255 Euro në muaj të hyra në familje. Kategoria e katërt dhe e pestë ky hyjnë vetëm 49 të anketuar apo më pak se 5% e tyre arrijnë të gjenerojnë të hyra mbi 300 euro në muaj.

Tabela 2. Vlera e të hyrave mujore

Numri i të anketuarve	Vlera e të hyrave mujore	Mesatarja e të hyrave mujore
271	0-100 €	90 €
618	101-200 €	155 €
217	201-300 €	255 €
46	301-400 €	353 €
3	401+ €	516 €

Në përgjithësi, dallime të theksuara rreth gjendjes së të hyrave në krahasime mes komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptiane nuk janë identifikuar. Sidoqoftë, vlen të cekët se mesatarisht vetëm 167 Euro është shuma që këta të anketuar kanë si burim të të hyrave mujore në familjet e tyre.


Nëse marrim për bazë vlerën 167 Euro (që është edhe më e vogël se paga minimale e një punëtori në Kosovë), dhe e përpjesëtojmë me numrin e anëtarëve të familjes mesatarisht që është 7 anëtar, lë të kuptohet se 23.85 Euro janë të hyra për person në atë familje në muaj, ose 0.79 Euro në ditë. Këto shifra si dhe struktura e burimeve të të hyrave të tyre shfaqin qartë nivelin e varfërisë së lartë që këto komunitete jetojnë në Kosovë.

3.3. Punësimi dhe jetesa – Indikatorët e tregut të punës

Ky seksion është një ndër pjesët më të rëndësishme të të gjeturave në këtë hulumtim. Gjetjet rreth statusit të punësimit, aftësisë për të hyrë në tregun e punës, masat e (pa) shfrytëzuara nga institucionet përkatëse shpërfaqin gjendjen e rënduar të këtyre komuniteteve, si para pandemisë e me thekës të veçantë gjatë pandemisë.

Niveli i ulët i punësimit është një prej problemeve më të mëdha socio-ekonomike në Kosovë. Bazuar në Anketën e Pulsit Publik⁴, 78% e qytetarëve e shohin papunësinë si problemin më të madh në Kosovë. Për më tepër, Raporti i Zhvillimit Njerëzor (2010) raporton se shkalla e papunësisë në familjet e komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian në vitin 2009 ishte rreth 58%, në krahasim me mesataren e popullatës prej 45%⁵.

Figura 3. Statusi i punësimit



Në pyetjen se cili është statusi i tyre i punësimit, siç mund të shihet tek figura 3., përkundër që të gjithë të anketuarit janë të moshës së duhur për të qenë në tregun e punës, 62% e tyre janë të papunë, ndërsa vetëm 8% nga ta janë të punësuar. Pjesa tjetër prej 30% e tyre deklarohen si të vetëpunësuar.

Për shkak të jo dallimeve të në mes të tre komuniteteve apo komunave, këto gjetje u përqendruan në krahasimet ndërmjet gjinisë dhe vendbanimeve (urbane, gjysmë-urbane, rurale).

⁴ Programi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillim, UNDP, Puls i Publik XI, Maj 2016

⁵ Programi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillim, UNDP, Raporti i Zhvillimit Njerëzor, 2010

Tabela 3., ilustron në detaje numrat dhe përqindjet e statusit të punësimit të krahasuar me gjininë dhe vendbanimin.

Tabela 3. Të dhënat e statusit të punësimit bazuar në gjininë, vendbanimin dhe arsimin

Statusi i punësimit	I/e punësuar		I/e vetëpunësuar		I/e papunë		Total	
Gjinia	Numri	%	Numri	%	Numri	%	Numri	%
Mashkull	51	55%	314	90%	216	30%	581	50%
Femër	41	45%	33	10%	500	70%	574	50%
Total	92	8%	347	30%	716	62%	1155	100%
Vendbanimi	Numri	%	Numri	%	Numri	%	Numri	%
Rural	26	28%	102	29%	293	41%	421	36%
Semi urban	20	22%	133	38%	236	33%	389	34%
Urban	46	50%	112	32%	187	26%	345	30%
Total	92	8%	347	30%	716	62%	1155	100%
Edukimi	Numri	%	Numri	%	Numri	%	Numri	%
Arsimi Fillor	61	66%	220	63%	352	49%	633	55%
Arsimi i Mesëm	15	16%	26	7%	52	7%	93	8%
Arsimi i Lartë	2	2%	0	0%	6	1%	8	1%
Arsimi pas-universitar	1	1%	0	0%	0	0%	1	0%
Pa arsim zyrtar	13	14%	101	29%	306	43%	420	36%
Total	92	8%	347	30%	716	62%	1155	100%


Kjo tabelë tregon se femrat janë shumë mbraja kur krahasohen me meshkujt në lidhje me sigurimin e të ardhurave përmes çfarëdo lloji të punësimit. Shkalla e papunësisë së grave është 70% krahasuar me burrat që është 30%. Në lidhje me vetëpunësimin, ndryshimi është jashtëzakonisht i lartë, ku vetëm 10% e grave janë të vetë punësuar krahasuar me burrat me 90%. Duhet të theksohet se vetëpunësimi i tyre është një lloj pune që nuk është i rregullt dhe shumicën e kohës, siç zbulon ky studim, është në sektorin informal dhe zakonisht është një punë / shërbim i kryer me një tarifë ditore ose ore.

Ato komunitete që jetojnë në zonat rurale kanë një normë më të lartë të papunësisë (pa të ardhura nga ndonjë lloj punësimi) me 41%, krahasuar me zonat gjysmë-urbane (33%) dhe ato urbane (26%).

Nga të gjithë të anketuarit e papunë, 92% e tyre ose kanë përfunduar vetëm arsimin fillor (49%), ose nuk kanë fare arsim zyrtar (43%).

Në nën pyetjet e bëra, të gjeturat tregojnë se situata është shumë më e rënduar duke u bazuar në llojin dhe sektorin e (vet)punësimit si të paqëndrueshme.

Figura 3.1. Lloji i punësimit



Nga 91 (8%) e anketuarve të punësuar, 26 prej tyre kanë dy lloje të punëve, ndërsa vetëm 19 nga ta janë të punësuar afatgjatë.

Nga të punësuarit afatgjatë rreth 75% e tyre deklarojnë se kanë në plan ta vazhdojnë punën aktuale, rreth 18% e tyre dëshirojnë që të fillojnë biznesin e tyre, 7% nga ta dëshirojnë ta

ndërrojnë punën aktuale, ndërsa asnjëri nga ta nuk dëshirojnë që ta ndërkrejnë përkohësisht punën.

Figura 3.1 tregon se rreth 70% e të punësuarve punojnë me orar të plotë, ndërsa më shumë se 26% e tyre punojnë në sektorin jo formal, të përkohshëm apo sezonal.


Tabela 3.1. Të dhënat e të punësuarve me kohë të plotë bazuar në gjininë, vendbanimin dhe arsimin

Të punësuar me orar të plotë					
Gjinia	Numri	Vendbanimi	Numri	Edukimi	Numri
Mashkull	36	Rural	18	Arsimi Fillor	44
Femër	28	Semi urban	12	Arsimi i Mesëm	10
		Urban	34	Arsimi i Lartë	2
				Arsimi pas-universitar	1
				Pa arsim zyrtar	7
Total	64	Total	64	Total	64

Meqenëse vetëm 64 të anketuar janë të punësuar me kohë të plotë, me gjenerimin më të lartë të të ardhurave tabela 3.1., shkon më thellë në krahasimin e këtyre punonjësve me kohë të plotë bazuar në gjininë, vendbanimin dhe edukimin. Gratë janë dukshëm më pak të punësuar sesa burrat. Për më tepër, ata që jetojnë në zona urbane duket se kanë më shumë mundësi punësimi krahasuar me ata që jetojnë në zona rurale dhe gjysmë-urbane së bashku. Vetëm 7 nga 306 të anketuar pa arsim zyrtar kanë arritur të sigurojnë një punë me kohë të plotë.

Në figurën 3.1.1., tregon se shumica e të punësuarve të këtyre komuniteteve janë të punësuar në sektorët që kërkojnë punë fizike. Punët në sektorin e mirëmbajtjes dhe ndërtimtarisë janë më të spikaturat.

Figura 3.1.1. Sektori i punësimit




Të vetë punësuarit

Ndonëse afër 1/3 apo 30% e të anketuarve deklarohen si të vetë punësuar, të dhënat tregojnë se edhe ky lloj i punës në të shumtën e rasteve është i paqëndrueshëm, jostabil, dhe kryesisht në sektorët ku kërkohet punë fizike.

Figura 3.2.1., tregon se shumica e të anketuarve janë të vetë punësuar në sektorët apo profesionet si: grumbullues të metaleve, ndërtimtari dhe agrikulturë. Këta sektorë apo profesione kanë kryesisht të hyra jostabile, kryhen kryesisht nga burrat (kjo është arseja pse 90% e të gjithë të vetë punësuarve janë burrat) dhe hyjnë në ekonominë jo formale dhe sezonale.


Figura 3.2.1. Sektori apo profesioni i vet-punësimit



Siç u cek edhe më lartë, duke ju referuar figurës 3.2.2., të vetë punësuarit operojnë kryesisht në sektorin jo formal me 95% prej tyre, ku 60% e tyre bëjnë pjesë në sektorin e rregullt jo formal dhe 35% në sektorin sezonal jo-formal. Jo-formaliteti pothuajse në shkallë absolute, pa përfshirë ndikimin në ekonominë e vendit, ndikon negativisht tek ta dhe përgjithësisht në mundësitë e rritjes apo zgjerimit

të tyre në aspektin biznesor. Përveç kësaj, këta të vetë punësuar nuk figurojnë në të dhënat zyrtare të Agjencisë së Punës apo institucioneve tjera si biznese apo të vetë punësuar dhe rrjedhimisht, në mungesë të këtyre të dhënave, gjasat janë të mëdha që të mos përfshihen në skemat apo masat adekuate për ta, apo përfshihen në skema apo masa që nuk janë për ta.

Figura 3.2.2. Lloji i vetë punësimit



Të papunët

Ndonëse numri i të papunëve tek këto komunitete është tejet i lartë, vetëm 40% e tyre janë të regjistruar në Zyrat e Punësimit në kuadër të APRK-së si të papunë. Gjatë pandemisë, 20% e të papunëve janë regjistruar në Zyrat e Punësimit, si një prej kushteve për të përfituar nga Masa 15 e pakos emergjente financiare e cila ofron pagesë mujore prej 130 Euro për personat e papunë dhe që nuk marrin ndonjë asistencë tjetër sociale. Përsëri, kur krahasohet me statistikën e përgjithshme të popullsisë së Kosovës, gjatë së njëjtës periudhë numri i të papunëve të regjistruar si punëkërkues është trefishuar, ndërsa në këto komunitete janë rritur vetëm në 20%.

Ndër arsyt kryesore të mos regjistrimit si të papunë janë: kushtet shëndetësore, obligimet familjare, dhe mungesa e shpresës se APRK-ja do mund të ju ndihmonte atyre për të gjetur një punë.

Figura 3.3.1. Regjistrimi në APRK si të papunë





Figura 3.3.2. Periudha e regjistrimit



Analiza e statusit të papunësisë, siç mund të vërehet në figurën 3.3.3., 84% e tyre janë të papunë afatgjatë (më se 12 muaj), dhe 8% e tyre janë të papunë si pasojë e pandemisë.

Figura 3.3.3. Statusi i papunësisë




Tabela 3.3.3. Të papunë afatgjatë (më shumë se 12 muaj). Të dhëna bazuar në gjininë, vendbanimin dhe arsimin


Të dhënat për të papunë afatgjatë					
Gjinia	Numri	Vendbanimi	Numri	Arsimi	Numri
Mashkull	142	Rural	235	Arsimi Fillor	309
Femër	443	Semi urban	206	Arsimi i Mesëm	31
		Urban	144	Arsimi i Lartë	4
				Arsimi pas-universitar	0
				Pa arsim zyrtar	241
Total	585	Total	585	Total	585

Meqenëse të papunët afatgjatë (më shumë se 12 muaj) janë 81.7% e të gjithë të anketuarve të papunë, dhe për shkak se ky grup përballet me pengesat dhe sfidat më të vështira për të përballuar çështjet socio-ekonomike, në tabelën 3.3.3., janë dhënë në detaje numrat e të anketuarve të papunë afatgjatë bazuar në gjininë, vendbanimin dhe arsimimin. Ashtu si në tabelat e mëparshme të ndër-të-dhënave, në këtë tabelë mund të vërehet mospërputhja midis gjinisë - ku 443 ose 75.7% e të papunëve afatgjatë janë gra. Ky numër i lartë i grave të papuna për një kohë të gjatë është për shkak të detyrimeve familjare (detyrat e amvisërisë, detyrimet e familjes dhe kujdesit për fëmijët dhe se asnjëherë nuk kanë pasur mundësi të hyjnë në tregun e punës). E njëjta mospërputhje ekziston midis vendbanimeve - ku ka vetëm 144 ose 24% të të anketuarve që jetojnë në zonat urbane duke qenë të papunë për një kohë të gjatë krahasuar me zonat rurale dhe gjysmë-urbane ku situata është më e keqe. Si në të gjitha kategoritë e papunësisë - në punësimin afatgjatë, shumica e tyre janë ose pa arsim zyrtar (41.2%) ose me vetëm arsimin fillor të përfunduar (52.8%).

Si pasojë e kësaj, në pyetjen se a jeni të interesuar për punë, nga 716 e të papunëve, vetëm gjysma e tyre deklarohen që janë të interesuar për punë, ndërsa gjysma tjetër as nuk janë të interesuar për punë. Kjo e bënë edhe më të vështirë gjetjen e mënyrave për t'i inkuadruar në tregun e punës në


momentin që motivi apo vullneti për të punuar mungon. Kjo shkallë e lartë e mos interesimit për punë shpjegohet me kalimin e një kohe të gjatë pa punuar.

Figura 3.3.4. Interesimi për punë




Për personat që janë të interesuar të punojnë, figura 3.3.5 ilustron përpjekjet e tyre shumë të vogla për të hyrë në tregun e punës nëpërmjet aplikimeve për punë. Në pyetjen se sa herë keni aplikuar për ndonjë punë gjatë muajit të kaluar, 307 apo 85% prej tyre deklarojnë se nuk kanë aplikuar, dhe vetëm 39 apo rreth 10% prej tyre deklarojnë se kanë aplikuar 1-5 herë. Pothuajse i njëjti trend është edhe në pyetjen e njëjtë rreth aplikimit për punë në gjashtë muajt e kaluar. Shifrat shumë të ulëta rreth aplikimeve e shpjegojnë edhe numrin tejet të ulët të thirrjeve në intervista për punësim.

Figura 3.3.5. Aplikimet për punësim




Këto komunitete janë shprehur që e shfrytëzojnë rrjetin e shoqërisë dhe familjes. Zyrat komunale të punësimit në kuadër të APRK-së dhe rrjetet sociale janë dy format tjera të kërkimit për punë që theksohen si më të shpeshtat.

Figura 3.3.6. Format e kërkimit për punë



Në kuadër të formave të aplikimit për punë, këto komunitete më së shumti e përdorin formën e aplikimit fizikisht në kompani.

Figura 3.3.7. Format e aplikimit për punë




Meqenëse niveli i tyre i interesimit për punë nuk është i kënaqshëm, njëjtë sikurse edhe rezultatet e përpjekjeve të atyre që janë të interesuar për punë janë tejet të zymta, në pyetjen e radhës se sa jeni të sigurtë në fazat e aplikimit për punë, në një shkallë prej 1 deri në 5, ku 1 është “shumë i sigurt” dhe 5 “aspak i sigurt” tek tri fazat e aplikimit për punë: CV, Intervista, dhe Letra Motivuese, figura 3.3.8., tregon se shumica e të anketuarve ndihen aspak të sigurt.

Kjo figurë, na lë të kuptojmë se kualiteti i aplikimit për punë nga ana e tyre është tejet i dobët dhe rrjedhimisht, përkundër faktit se ata mund ta bëjnë punën shumë mirë, ata nuk arrijnë që ta bindin një kompani për të ja u ofruar mundësinë për ta dëshmuar veten në punë, duke mos arritur të kenë një aplikim të suksesshëm dhe kualitativ.

Këto të gjetura, identifikojnë nevojën e lartë që këtyre komuniteteve të ju ofrohen shkathtësitë dhe njohuritë e duhura për të përformuar suksesshëm në proceset e hulumtimit dhe aplikimit për punë. Këto shkathtësi të cilat bëjnë pjesë në fushën e shkathtësive të buta, janë tejet të rëndësishme dhe kërkojnë pashmangshëm nga punëdhënësit, pavarësisht llojit të punës.

Figura 3.3.8. Vetëbesimi në fazat e aplikimit për punë



Në perceptimin e punëkërkuësve, në pyetjen se cilat janë arsye që ju besoni se jeni të papunë, arsyet më të shpeshta që ata besojnë se i lë të papunë janë: mungesa e eksperiencës, obligimet familjare (përkujdesja për familje dhe fëmijë) dhe diskriminimi janë tri arsyet më të përmendura nga ta.

Mbështetja nga Zyra e Punësimit

Bazuar në strategjinë e qeverisë së Kosovës: Strategjia për Përfshirjen e Komuniteteve Rom dhe Ashkali në Shoqërinë Kosovare (2017-2021)⁶, e cila është e adaptuar nga Korniza Bashkimit Evropian, ka katër fusha: **Arsimi, Punësimi dhe Mirëqenia Sociale, Shëndetësia dhe Banimi**. Për secilën nga katër fushat e strategjisë është definuar një objektiv strategjik, i cili është zbërthyer në rezultate, dhe rezultatet në aktivitete.

Siç ceket në strategjinë e Q.K., nga pikëpamja e politikë bërjes janë dy mekanizma kyç për promovimin e punësimit të komuniteteve pakicë:

- Korniza ligjore për rregullimin e përfaqësimit në punësim të pjesëtarëve të komuniteteve jo-shumicë në shërbimin civil; dhe
- Masat aktive të tregut të punës të realizuara nga Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale (Agjencia e Punësimit e Republikës së Kosovës nëpërmjet Zyrave të Punësimit), në bashkëpunim me ministri tjera relevante dhe donatorë.


Ky hulumtim tregon se 50% e këtyre komuniteteve nuk kanë marrë kurrë ndonjë shërbim apo mbështetje të vetme nga Zyra e Punësimit. Derisa 38% kanë marrë shërbime/mbështetje më herët, dhe momentalisht vetëm 12% e tyre pranojnë mbështetje nga ZP-të e komunave përkatëse.

Figura 3.4., është tregues se njoftimet e masave, programeve apo shërbimeve që ZP-të në kuadër të APRK-së ofrojnë, pranohen apo arrijnë të promovohen në nivel të ulët tek këto komunitetet. Tregues

⁶ Strategjia për përfshirjen e komuniteteve rom dhe ashkali në shoqërinë kosovare (2017-2021), Zyra për Qeverisje të Mirë, Zyra e Kryeministrit, Qeveria e Kosovës.

tjetër që nuk duhet anashkaluar është edhe fakti se një pjesë e madhe e tyre nuk kanë shpresë se këto institucione mund t'i fusin në tregun e punës.

Figura 3.4. Mbështetja nga Zyra e Punësimit - ZP



Nga hulumtimi i të dhënave të publikuara nga APRK, Sistemi i Informativ për Menaxhimin e Punësimit - SIMP tek raportet statistikore për periudhën 01.01.2020 – 14.09.2020 nëse krahasojmë numrin e të regjistruarve të këtyre komuniteteve dhe numrin e ndërmjetësimeve për punësime të rregullta, është dukshëm i vogël. Nga totali i këtyre komuniteteve të regjistruara si punëkërkuar (2,015 persona), vetëm 16 ose 0.79% nga ta kanë arritur të përfitojnë nga ndërmjetësimet në punësimet e rregullta, përderisa për totalin e përgjithshëm kjo përqindje shkon për 1.19% apo rreth 45% më lart se sa komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian.


Tabela 3.4. Të dhëna krahasuese nga SIMP, APRK rreth regjistrimit si punëkërkuar dhe ndërmjetësimit për punë të rregullt

01.01.2020 - 14.09.2020		Burimi: Sistemi Informativ për Menaxhimin e Punësimit, APRK						
Etniteti	Punëkërkuarët e Regjistruar				Ndërmjetësimet në punësime të rregullta			
	Totali	Femër	Mashkull	%	Totali	Femër	Mashkull	%
Shqiptar	62,286	28,533	33,753	75.56%	916	379	537	93.37%
Serb	14,008	6,703	7,305	16.99%	26	12	14	2.65%
Boshnjak	2,421	1,209	1,212	2.94%	7	3	4	0.71%
Kroat	115	55	60	0.14%	2	2	0	0.20%
Rom	633	279	354	0.77%	4	1	3	0.41%
Ashkali	620	243	377	0.75%	4	1	3	0.41%
Egjiptas	762	348	414	0.92%	8	0	8	0.82%
Malazez	65	33	32	0.08%	0	0	0	0.00%
Turk	666	306	360	0.81%	8	6	2	0.82%
Tjetër	856	433	423	1.04%	6	2	4	0.61%
Total	82,432	38,142	44,290	100.00%	981	406	575	100.00%

Për të analizuar më në detaje llojet e masave që këto komunitete përfitojnë, apo llojet e shërbimeve që ato marrin, figura 3.4.1., ilustron se përgjithësisht këto komunitete marrin apo kanë pranuar vetëm këshillime gjatë procesit të regjistrimit si të papunë. Ndërsa vetëm 12% e atyre që kanë ose janë duke marrë mbështetje nga ZP-të e APRK-së, deklarojnë se përfitojnë nga Masat Aktive të Tregut Punës (MATP), ku prinë Aftësimi Profesional në Qendrat e Aftësimit Profesional – QAP.


Marrë parasysh numrin total që këto komunitete përbëjnë në popullatën në tërësi të Kosovës, dhe shkallën e lartë të të papunëve nga këto komunitete, këto shifra janë shumë të vogla duke krahasuar gjendjen dhe nevojat e tyre. Kjo dëshmohet gjithashtu në tabelën e mësipërme 3.4., të dhënat e nxjerra nga baza e të dhënave e Agjencisë së Punësimit.

Figura 3.4.1. Numri i përfituesve të masave aktive të tregut të punës nga ZP-të e APRK-së



Bazuar në mungesën e theksuar të përfshirjes në Masat Aktive të Tregut të Punës (MATP), pashmangshmërisht nevojitet të identifikohet edhe niveli i perceptimit të këtyre komuniteteve rreth masave nga ZP-të që ata vlerësonin se mund të japin vlerësim sipas perceptimit apo eksperiencës së tyre. Në pyetjen e radhës se sa si i perceptoni masat aktive veç e veç, në një shkallë prej 1 deri në 5, ku 1 është “shkëlqyeshëm” dhe 5 “shumë keq”, vërehet se ata kanë një perceptim apo përshtypje relativisht të dobët me përfashtim të këshillimeve.

Figura 3.4.2. Perceptimi i Masave Aktive të Tregut të Punës nga ZP-të



3.4. Edukimi

Ky seksion i raportit hulumtues pasqyron nivelin e edukimit formal dhe jo-formal të komunitetit rom, ashkali dhe egjiptian.

Nga hulumtimi i bërë, prej 1155 të anketuarve, 419 apo rreth 36% e tyre nuk kanë përfunduar ndonjë nivel të arsimit zyrtar (formal), ndërsa 633 apo më pak se 55% e tyre e kanë të përfunduar vetëm arsimin fillor dhe më pak se 10% e tyre (93) kanë arritur të përfundojnë arsimin e mesëm.

Ndonëse Ministria e Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë (MASHT) ka nxjerrë Udhëzimin Administrativ (UA Nr.09.2016)⁷ për aplikim të masave afirmative dhe vendeve të rezervuara për regjistrim të kandidatëve nga komunitetet jo shumicë në institucionet publike të arsimit të lartë, më pak se 1% e tyre kanë vazhduar në përfundimin e arsimit të lartë. Vetëm një nga të gjithë të anketuarit ka të përfunduar arsimin pas-universitar.

Të dhëna përafërsisht të njëjta na jep edhe figura 4.1.2., rreth edukimit më të lartë formal të familjarëve. Shqetësuese është fakti se 158 familje nuk kanë as edhe një anëtar të vetëm të familjes me ndonjë nivel të edukimit zyrtar.

Këto të dhëna kaq të ulëta rreth përgatitjes së tyre arsimore, na bëjnë të identifikojmë një prej shkaqeve kryesore se pse këto komunitete e kanë shumë më të vështirë hyrjen në tregun e punës. Bazuar në vlerësimet e Bankës Botërore dhe UNDP-së në të dhënat e Anketës Rajonale për rom, ashkali dhe egjiptian (UNDP-BB-KE 2017), vetëm 22% e të rinjve janë të punësuar, në shkollim ose trajnim (në punësim, arsim, ose trajnim – EET) për dallim nga të rinjtë e komuniteteve tjera me 53%. Pra, 78% e të rinjve rom, ashkali dhe egjiptian nuk janë as në punësim, edukim apo trajnim (NEET).

Figura 4.1.1. Niveli i edukimit formal




Figura 4.1.2. Niveli më i lartë i edukimit formal të familjarëve




Tabela 4.1.1. Niveli i arsimit formal bazuar në gjininë dhe vendbanimin

⁷ UA Nr.09.2016 Aplikimi i masave afirmative dhe vendeve të rezervuara për regjistrim të kandidatëve nga komunitetet joshumicë në institucionet publike të arsimit të lartë <https://masht.rks-gov.net/uploads/2016/06/ua-masht-09-2016-aplikimi-i-masave-afirmative-dhe-vendeve-te-rez-al.pdf>

Arsimi	Total	Mashkull	Femër	Rural	Semi-urban	Urban
Arsimi Fillor	633	336	297	223	194	216
Arsimi i Mesëm	93	27	66	48	18	27
Arsimi i Lartë	8	3	5	3	0	5
Arsimi pas-universitar	1	0	1	0	0	1
Pa arsim zyrtar	420	176	244	147	177	96
Total	1155	542	613	421	389	345

Tabela 4.1.1., jep në detaje të dhëna të kryqëzuara të nivelit të arsimit midis gjinisë dhe vendbanimit. Në lidhje me gjininë pa arsim zyrtar gratë janë me 58% krahasuar me burrat me 42%, ndërsa me arsimin fillor burrat kryesojnë me 53% krahasuar me gratë me 47%. Sidoqoftë, disa të dhëna interesante tregohen në nivelet e tjera të arsimit, ku gratë udhëheqin pozitivisht. Me arsimin e mesëm prej atyre që kanë përfunduar janë 70.9% nga gratë dhe 29.1% nga burrat. Megjithëse në numër të ulët në lidhje me arsimin e lartë, gratë kryesojnë edhe në këtë nivel arsimi, me 62.5% nga totali që e kanë të përfunduar. Nga të gjithë të anketuarit, vetëm një u përgjigj me përfundimin e arsimit pasuniversitar e cili ishte nga një femër. Të dhënat nga kjo tabelë tregojnë se gratë, kur u jepet mundësia, janë më të vendosura dhe ambicioze. Sidoqoftë, në përgjithësi ato janë të kufizuara të hyjnë në rrugën e edukimit për shkak të moshës së hershme me detyrime familjare, martesë të hershme dhe diskriminimit të theksuar në aspektet gjinore dhe etnike.

Gjatë analizimit të të dhënave të nivelit të arsimit me vendbanimet e të anketuarve nuk kishte ndryshime shumë të mëdha, përveç në fushën e jo-arsimit zyrtar, ku shumica ishin nga zonat rurale dhe gjysmë-urbane.

Ndonëse gjendja e edukimit formal e këtyre komuniteteve është tepër e rëndë, edhe më keq pasqyrohet në edukimet jo formale – nëpërmjet trajnimeve të ndryshme profesionale apo teknike që ofrohen nëpër Kosovë.

Nga të gjeturat e këtij hulumtimi, del se vetëm 8% e të anketuarve kanë ndjekur ndonjë trajnim profesional, prej të cilëve më shumë se gjysma i kanë ndjekur në Qendrat e Aftësisit Profesional në kuadër të APRK-së, siç mund të shihet në figurat 4.2.1. dhe 4.2.2.

Figura 4.2.1. Ndjekja e trajnimeve profesionale




Figura 4.2.2. Ofruesit e trajnimeve





Tabela 4.2.1. Kursantët bazuar në Ofruesit, Gjininë dhe Statusin e Punësimit

Ofruesit e Trajnimeve	Total	Gjinia		Statusi i Punësimit		
		Mashkull	Femër	I/e punësuar	I/e vetëpunësuar	I/e papunë
Qendrat e Aftësimi Profesional	52	33	19	12	24	16
Ofruesit e Tjerë të Trajnimeve	42	27	15	7	10	25
Total	94	60	34	19	34	41

Tabela 4.2.1., nga të gjithë të anketuarit e trajnuar 55% e tyre e kanë ndjekur atë në Qendrat Publike të Trajnimit Profesional, ndërsa 45% e tyre kanë ndjekur trajnime të caktuara nga ofruesit e tjerë të trajnimit. Në lidhje me gjininë, si në fushat e tjera (arsimi dhe llojet e punësimit), në ndjekjen e trajnimit, gratë bien me vetëm 36% krahasuar me burrat me 64%. Grupi i të anketuarve që kanë ndjekur trajnime të caktuara siç tregohet në këtë tabelë, aktualisht vetëm 56% e tyre janë të punësuar (20 %) ose të vetëpunësuar (36%), ndërsa 36% e të gjithë atyre janë akoma të papunë. Kalimi nga trajnimi në punësim është në një nivel të ulët. Lidhur me komunitetet që kanë ndjekur trajnim profesional ose teknik, kurset kryesore janë ato të rrobaqepësisë, vetë punësimit/sipërmarrjes dhe ndërtimit me nën-sektorët përkatës.

Ju lutemi referojuni Grafikut 4.2.3., Për më shumë detaje, pasi tregon profesionet më të ndjekura.

Figura 4.2.3. Fushat e trajnimeve



Periudha e pandemisë gjatë së cilës shkollat filluan të operojnë online, në platforma virtuale, raportimet hulumtuese (ADMOVE, 2020)⁸ tregojnë se këto komunitete kanë qenë të përjashtuara nga mësimi në distancë në mungesë të pajisjeve digjitale.

⁸ http://admovere.org/wp-content/uploads/2020/07/Final_-_Sfidat-e-komunitetit-rom-ashkali-dhe-egjiptian-ne-kosove-giate-pandemise-COVID-19-Alb-.pdf

Përkundër nivelit të ulët të pjesëmarrjes në edukimin qoftë formal apo jo-formal, hulumtimi tregon se vetëm 37% e tyre planifikojnë që të vazhdojnë edukimin e tyre. Nga ata që planifikojnë të vazhdojnë edukimin, më pak se 10% e kanë fjalën për edukimin formal, afër gjysma e tyre planifikojnë të ndjekin trajnime profesionale, dhe pjesa tjetër në marrjen e aftësive teknike/zanateve nëpërmjet kanaleve jo-formale, siç ilustron në figurat e mëposhtme 4.3.1. dhe 4.3.2.

Figura 4.3.1. Planifikimi për vazhdimin e edukimit





Figura 4.3.2. Forma e vazhdimin të edukimit




3.5. Ndikimi i COVID-19 në statusin socio-ekonomik të komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian

Ky seksion i raportit hulumtues, analizon dhe pasqyron në detaje dhe në mënyrë më të specifikuar ndikimin e pandemisë në statusin socio-ekonomik të komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian duke përfshirë aspektin social, ekonomik, si dhe atë shëndetësor e psikik.

3.5.1. Ndikimi i pandemisë në aktivitetin social

Hulumtimi tregon se janë dy faktorë që kanë ndikuar negativisht në aktivitetin social të komuniteteve, si: lëvizja e limituar dhe ndalimi i tubimeve/vizitave familjare apo shoqërore, të përcjellura me limitimin e hapësirave publike dhe rekreative. Përgjithësisht në këtë aspekt, janë pothuajse të njëjtët faktorë që përmenden edhe nga grupe të tjera të hulumtimeve të kryera rreth ndikimit social të pandemisë.

Figura 5.1. Ndikimi i pandemisë në aktivitetin social



3.5.2. Ndikimi i pandemisë në aktivitetin ekonomik


Ky nën-seksion i raportit hulumtues është i ndarë në tri pjesë, përkatësisht për tri grupe: për të punësuarit, për të papunët, dhe për të vetë punësuarit, për të identifikuar ndikimin e pandemisë në aktivitetin ekonomik të tyre duke përfshirë edhe ndihma apo mbështetje që kanë marrë deri më tash me theks të veçantë tek Pako Emergjente Fiskale nga Ministria e Financave dhe Transfereve e Qeverisë së Kosovës, e përbërë nga 15 Masa⁹.

Për të punësuarit

Nga të punësuarit e deklaruar, edhe pse të paktë në numër, prej tyre 9% janë larguar nga puna si pasojë e pandemisë dhe 7% të tyre u është shkurtuar orari i punës. Ndërsa 56% e tyre kanë hyrë në grupin e ndërprerjes së përkohshme dhe të detyrueshme të punës. Ky numër është tepër i lartë dhe shqetësues marrë parasysh faktin dhe gjasat se shumë lehtë mund të largohen nga puna me një vendim të thjeshtë, e sidomos nëse situata e pandemisë përkeqësohet edhe më shumë janë të mëdha. Nga të gjithë të punësuarit e deklaruar vetëm tek 28% prej tyre nuk ka ndikuar pandemia në punën e tyre.


Ndërhyrja me masa adekuate nga institucionet relevante është më se e domosdoshme për të zbutur këtë trend të frikshëm dhe negativ, sidomos tek këto komunitete.

Figura 5.2.1.1. Ndikimi i pandemisë në punë



Prej të punësuarve të deklaruar, 68% e tyre e pranojnë rrogën nëpërmjet bankës, gjersa 32% e tyre paguhet kesh.


Figura 5.2.1.2. Format e marrjes së pagës



⁹ Masat e Pakos Emergjente: <https://mf.rks-gov.net/desk/inc/media/8810F09D-B3C7-4E09-9BD1-0E2B0B2AF5CB.pdf>

Ndikimi i pandemisë në rrogë është në përputhje me numrin e personave që ju është shkurtuar orari si dhe disa nga ta të cilët ndonëse janë në pauzë të detyrueshme të punës, ju bëhet një pagesë e zvogëluar mujore me qëllim të ruajtjes së atyre punëtorëve edhe pse ky është numër i ulët i këtyre rasteve. Figura 5.2.1.3, tregon se tek 20% e tyre ka ndikuar në zvogëlim të pagës, ndërsa tek pjesa tjetër nuk ka ndikuar fare në pagë, dhe nuk ka raste të rritjes së pagës mujore, ndonëse ka raste që në sektorë të veçantë punët janë shtuar.


Figura 5.2.1.3. Ndikimi i pandemisë në rrogë



Bazuar në pakon emergjente fiskale të krijuar nga Qeveria e Kosovës, veçanërisht nga Ministria e Financave dhe Transfereve, 3 nga 15 masat e asaj pako kanë qenë të dedikuara për punëtorët. Masa 3.A. (mbulesa e pagesës së pagës në vlerë prej 170 euro në muaj për dy muaj) për punëtorët që vazhdojnë punën në të gjithë sektorët formal dhe privat të ekonomisë së Kosovës, vetëm 54 nga 91 të punësuar nga këto komunitete kanë përfituar nga kjo masë. Ndërsa, sa i përket masave të tjera: Masa 6 dhe 7 për sektorë të veçantë me paga shtesë, nuk ka përfituar asnjë nga të anketuarit e këtyre komuniteteve.

Puna jo formale, dhe mungesa adekuate e informimit të tyre apo e punëdhënësve të tyre janë disa nga arsyet e numrave kaq të ulët të këtyre komuniteteve si përfitues të këtyre masave.

Figura 5.2.1.4. Përfitimi nga Masat për punëtorë nga Pako Emergjente Financiare e Q.K.




Për të papunët

Figura 5.2.2.1., tregon se nga të gjithë të papunësuarit, 69% prej tyre kanë përfituar nga asistencë sociale, ndërsa 31% prej tyre nuk kanë përfituar asnjëherë. Arsyeja e mos përfitimit të asistencës sociale nga afër 1/3 e të papunëve mund të shpjegohet duke analizuar procedurat e aplikimit për asistencë sociale, pasi që nuk mjafton vetëm fakti i të qenit i papunë që të përfitosh nga ajo asistencë ndonëse e vogël dhe e pamjaftueshme. Si procedurë, për të aplikuar dhe për të u konsideruar si përfitues i asistencës sociale, përfituesi që është i moshës për të punuar, duhet të vërtetojë mos aftësinë e tij për punë (shëndetësore), dhe/apo të dëshmojë se ka fëmijë nën moshën 5 vjeçare që janë të varur nga ai/ajo.


Rrjedhimisht, ndonëse ka raste kur personi është në gjendje dhe i aftë për punë, nuk ia del të gjejë punë – kjo përsëri nuk e kategorizon atë si pjesë e personave/rasteve që kanë të drejtë të përfitojnë asistencë sociale.

Figura 5.2.2.1. Numri i përfituesve të asistencës sociale, dhe llojet e saj



Nga Pako Emergjente Financiare e Qeverisë së Kosovës, 4 prej 15 masave janë të dedikuara për kategori të ndryshme të të papunëve. Siç janë të emërtuara në figurën 5.2.2.2., që të katër masat, vetëm në Masën 1 (pagesë e dyfishtë për përfituesit e asistencës sociale për dy muaj) kanë përfituar më shumë se gjysma e përfituesve të asistencës sociale. Ndonëse kjo masë ka qenë e përpiluar të ekzekutohet automatikisht tek të gjithë përfituesit aktual të asistencës sociale – janë afër 40% e të anketuarve që nuk pohojnë përfitimin nga kjo masë. Njësoj sikurse edhe tek masat e tjera për të punësuarit, edhe në masat e tjera për të papunët nga këto komunitete numrat e përfituesve janë tepër të ulëta.

Figura 5.2.2.2. Përfitimi nga Masat për të papunët nga Pako Emergjente Financiare e Q.K.




Për të vetë punësuarit

Që nga pandemia, rreth 41 të vetë punësuar apo afër 15% e të gjithë të vetë punësuarve nga këto komunitete kanë deklaruar se kanë ndaluar aktivitetin e tyre të punës si pasojë e limitimeve nga pandemia dhe kërkesa e vogël për shërbimet e tyre.

Në pyetjen se si operon ndërmarrja juaj si pasojë e pandemisë, figura 5.2.3.1., fokusohet tek ata të vet-punësuar që ende operojnë, dhe ilustron gjendjen e tyre në aspektin e orarit, stafit, dhe të të hyrave.


Sa i përket stafit, për arsye se këto janë kryesisht ndërmarrje mikro ku në të shumtën e rasteve punon vetëm i vetë punësuar (pa ndonjë punëtor), ky është treguesi më i theksuar se nuk ka pësuar ndryshim gjatë pandemisë. Ndërsa, ndryshimet negativisht më të theksuara janë në zvogëlim të orarit për afër gjysmës së këtyre ndërmarrjeve, dhe ulje të të hyrave për mbi 2/3 e këtyre mikro ndërmarrjeve, si pasojë e pandemisë.

Figura 5.2.3.1. Operimi i ndërmarrjes si pasojë e pandemisë



Duke e marrë parasysh faktin se 95% e të vetë punësuarve operojnë në sektorin e ekonomisë jo-formale, është shkak pse vetëm një numër shumë i vogël i ndërmarrjeve të tyre kanë pasur të drejtën që të përfitojnë nga 4 prej 15 masave të pakos emergjente financiare për ndërmarrjet e sektorit privat. Shumica e të vetëpunësuarve formal kanë përfituar në Masën 3.A që është subvencionimi i pagës prej 170 euro për dy muaj, dhe vetëm 2 prej tyre kanë përfituar nga Masa 3.B (subvencionimi i qerasë deri në 50%), ndërsa 4 nga ta kanë përfituar nga Masa 14 (mbështetja financiare prej 130 euro në muaj për dy muaj, për bizneset që regjistrojnë punëtorët me kontratë pune së paku 1 vjeçare).

Figura 5.2.3.2. Përfitimi nga Masat për ndërmarrjet nga Pako Emergjente Financiare



Obligimet mujore financiare


Përkundër aspektit të të hyrave nga punësimi, asistenca, apo format e tjera të të hyrave, ky hulumtim ka për qëllim të analizojë edhe situatën aktuale të obligimeve mujore që këto komunitete kanë dhe se si ja dalin ata me gjendjen aktuale të pandemisë.

Në pyetjen se si ja dilni me obligimet mujore financiare, duke specifikuar ato të përgjithshmet: rryma, mbeturinat, uji, kreditë, dhe qiraja, figura 5.2.4., ilustron gjendjen e këtyre obligimeve për secilën veç e veç.

Nga ky grafikon lë të kuptohet se mbi 95% e të anketuarve nuk kanë obligime të qerasë e që është një lehtësim i madh për ta, ndonëse ka raste që jetojnë në kushte të mjerueshme e të pabanueshme. Po ashtu, si pjesë e asistencës sociale siç edhe ky grafikon paraqet për një pjesë/sasi të caktuar të shpenzimeve të rrymës, ujit si dhe të mbeturinave – ata janë të liruar nga pagesa deri në një masë të caktuar. Përgjithësisht, tek obligimet mujore si rryma, mbeturinat, uji, dhe kreditë një pjesë e madhe e tyre janë vonë me pagesa e që mund të rezultojë në ndërprerjen e ofrimit të këtyre shërbimeve e që do ja u vështirësonte edhe më tej jetesën dhe ballafaqimin me pandeminë.

Ndërhyrja e institucioneve përkatëse apo ristrukturimi i këtyre obligimeve mujore që janë në vonesë nga ofruesit e shërbimeve përkatëse, do ja u lehtësonte jetesën këtyre komuniteteve të cilat vërehet se në të gjitha fushat qëndrojnë shumë më keq se sa popullata e Kosovës si tërësi.

Figura 5.2.4. Obligimet mujore financiare



Përfitimi nga pakot emergjente ushqimore dhe higjienike

Duke marrë parasysh se komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian janë ndër komunitetet me nivelin më të ulët të mirëqenies, sidomos në kohë krizash sikurse kjo e pandemisë, ky hulumtim identifikon se 70% e tyre kanë pranuar një apo disa pako ushqimore dhe higjienike nga institucione publike, organizata humanitare ndërkombëtare, apo/dhe humanist e fondacione të ndryshme lokale në Kosovë.

Figura 5.2.5.2., ilustron se nga 70% e tyre që kanë pranuar pako emergjente pothuajse të gjitha prej tyre kanë qenë të përbëra nga pako ushqimore si dhe higjienike.

Figura 5.2.5.1. Përfitimet me pako






Figura 5.2.5.2. Llojet e pakove



Më tutje, figura 5.2.5.3., ilustron shpërndarësit apo financuesit e këtyre pakove shumë të nevojshme për këto komunitete. Më shumë se gjysma e këtyre pakove, apo 52% e tyre janë të mbështetura nga komunat përkatëse, të cilat pasohen me shoqata e organizata të ndryshme humanitare vendore me 31%, dhe organizata ndërkombëtare me 9%.


Figura 5.2.5.3. Shpërndarësit/financuesit e pakove



3.5.3. Qasja në shërbimet shëndetësore


Një aspekt tjetër i rëndësishëm që ky hulumtim e mbulon është edhe qasja në shërbimet shëndetësore të këtyre komuniteteve që në shumë raste diskriminohen në baza të ndryshme. Figura 5.3.1., ilustron se shumica dërrmuese pranojnë shërbimet shëndetësore publike, me rreth 83% e tyre, ndërsa 5% e tyre deklarojnë se pranojnë shërbimet shëndetësore private apo që të dyja. Gjersa, 12% e tyre deklarojnë se nuk pranojnë fare shërbime shëndetësore për shkak që nuk kishin nevojë për to.

Figura 5.3.1. Lloji i shërbimeve shëndetësore




Në pyetjen se sa shpesh kanë nevojë për shërbime shëndetësore, figura 5.3.2., jep detaje të cilat nuk dallojnë shumë nga hulumtimet e bëra për popullsinë në tërësi në Kosovë.

Figura 5.3.2. Nevoja për shërbime shëndetësore



Në pyetjen se sa janë të qasshme shërbimet shëndetësore dhe çfarë performance kanë, ku sipas vlerësimit në shkallën prej 1-5, ku 1 është vlerësim shumë pozitiv dhe 5 shumë negativ, në figurën 5.3.3., vërehet se më shumë se gjysma e të anketuarve i vlerësojnë me notë shumë pozitive në aspektin e qasshmërisë dhe performancës së shërbimeve të cilat i marrin. Rreth 5% e të anketuarve i vlerësojnë me notë negative ose shumë negative performancën apo qasshmërinë e ofruesit të shërbimeve shëndetësore në Kosovë.

Figura 5.3.3. Vlerësimi i qasshmërisë dhe performancës së shërbimeve shëndetësore




3.5.4. Ndikimi psikik nga pandemia

Marrë parasysh se pandemia COVID-19 ka ndikim të shumë anshëm pavarësisht se a infektoheni apo jo, i gjithë procesi i ndërlikuar dhe i paqartë i marrjes së masave për parandalimin dhe kujdesin ndaj infektimit ka implikime të llojllojshme e që domosdoshmërisht ndikojnë edhe në shëndetin mendor.

Ndikimet në shëndetin mendor, jo radhë herë qojnë në acarime e deri edhe në dhunë ndërmjet njerëzve. Prandaj, pjesë e këtij hulumtimi është edhe ndikimi psikik nga pandemia.

Në pyetjen se sa ka ndikuar pandemia në nivelin e stresit tuaj, në një shkallë nga 1 deri në 5 (ku 1 është “shumë ndikim”, dhe 5 duke qenë “aspak ndikim”), siç mund të vërehet në figurën 5.4.1., 72% e tyre shprehin se ka ndikuar në stresin e tyre deri në një shkallë, ku 10% e tyre deklarojnë se ka ndikuar shumë. Vetëm 27% e tyre deklarojnë se nuk ka pasur aspak ndikim në stresin e tyre.


Figura 5.4.1. Ndikimi i pandemisë në nivelin e stresit



Element tjetër me rëndësi për të analizuar është edhe se si ka ndikuar limitimi i aktiviteteve fizike në shëndetin mental, emocional dhe fizik. Sipas figurës 5.4.2., për të tri këto aspekte janë vlerësuar në një shkallë nga 1 deri në 5 (ku 1 është “shumë ndikim” dhe 5 “aspak ndikim”).


Përgjithësisht, rreth 2/3 e të anketuarve shprehin se limitimi i aktiviteteve ka ndikuar deri në një shkallë në shëndetin e tyre mental dhe emocional, ndërsa gjysma e tyre deklarojnë se ka ndikuar deri në një shkallë edhe në shëndetin fizik. Bazuar në këtë figurë, vërejmë se ndikimi më i madh ka qenë në shëndetin emocional, pasuar me atë mendor dhe në fund atë fizik.

Figura 5.4.2. Ndikimi i limitimit të aktiviteteve



Për të hyrë më në detaje në vlerësimin e ndikimit të pandemisë në shëndetin mental, hulumtimi mbulon edhe më tej aspektin e ndikimit të pandemisë në acarime të marrëdhënieve familjare të cilat qojnë edhe në dhunë. Figura 5.4.3., tregon se 77% e tyre deklarojnë se nuk ndikon në acarimin e marrëdhënieve familjare të cilat mund të qojnë edhe në dhunë, ndërsa 12% prej tyre deklarojnë se nuk e dinë. Sidoqoftë, përderisa 11% e të anketuarve, përveç që pohojnë se ndikon, ata gjithashtu komentojnë se shumë prej njerëzve nuk e pranojnë publikisht, mirëpo që faktikisht ndikon në masë të madhe.

Figura 5.4.3. Ndikimi i pandemisë në acarime të marrëdhënieve familjare



Më tej, në pyetjen e ngjashme sikurse në atë paraprake, mirëpo tash me fokus karantinën; se a ka ndikuar karantina në acarime të marrëdhënieve familjare të cilat mund të qojnë edhe në dhunë, përgjithësisht figura 5.4.4., shfaq pothuajse të njëjtat rezultate sikurse pyetja 5.4.3.

Figura 5.4.4. Ndikimi i karantinës në acarime të marrëdhënieve familjare






Figura 5.4.5. Raste të dhunës në familje



Tek të anketuarit të cilët pajtohen se pandemia apo/dhe karantina ka ndikuar në acarime të marrëdhënieve familjare, më tutje janë pyetur nëse kanë dëgjuar për ndonjë rast të tillë. Figura 5.4.5., ilustron se 71% e tyre apo 104 persona kanë dëgjuar raste të tilla. Duke e marrë parasysh se kjo nuk është një temë aq e hapur, ky numër konsiderohet që të jetë shumëfish më i lartë.


Figura 5.4.6. Përhapja e kësaj dukurie në komunitetin tuaj



Në pyetjen e shtruar se sa është e përhapur kjo dukuri në komunitetin tuaj, nga 1-5 ku 1 është “shumë e përhapur” dhe 5 duke qenë “aspak e përhapur”, përgjigjet se është deri në një nivel e përhapur janë pothuajse në shkallë të njëjtë me ata që kanë deklaruar se kanë dëgjuar raste të dhunës dhe acarimeve familjare. Për arsye se kjo është një temë e ndjeshme, këto rezultate jo domosdoshmërisht e pasqyrojnë gjendjen reale.

Për fund të kësaj teme, në pyetjen për të gjithë të anketuarit se a keni informata se ku duhet të raportohet dhuna në familje, 12% e tyre nuk e dinë ndërsa 88% e tyre deklarojnë se e dinë ku duhet të raportohet duke përmendur policinë dhe ndihmën e shpejtë si adresat më të shpeshta si përgjigje.


Figura 5.4.7. Ku duhet të raportohet dhuna



3.5.5. Rastet e infektimit me COVID-19

Përkundër ndikimit të pandemisë në statusin socio-ekonomik të këtyre komuniteteve, ky hulumtim analizon edhe gjendjen e të infektuarve me virusin COVID-19. Siç pasqyrohet në figurën 5.5.1., nga të gjithë të anketuarit, 9 prej tyre kanë qenë të infektuar me virusin COVID-19, dhe 19 prej tyre kanë pasur familjar të infektuar me këtë virus.


Figura 5.5.1. Infektimet me COVID-19



Më tutje, figura 5.5.2., pasqyron se 86% e të infektuarve apo familjarët e infektuar janë trajtuar në shtëpi, ndërsa vetëm 14% e atyre rasteve kanë përdorur shërbimet e trajtimit nga QKUK-ja apo ndonjë spital tjetër publik.

Për më tepër, vlen të theksohet se nga 28 personat e infektuar asnjë nga ta nuk është mbështetur financiarisht, dhe vetëm një nga ta ka deklaruar se e ka humbur punën si pasojë e infektimit me këtë virus.

Figura 5.5.2. Trajtimi i tyre




3.5.6. Përbalimi financiar i COVID-19

Përveç pyetjeve rreth gjendjes së këtyre komuniteteve, ky hulumtim u orientua edhe në aspektin e vlerësimit nga ana e tyre, sidomos sa i përket përbalimit me pandeminë apo edhe rekomandimeve që ata kanë rreth APRK-së apo institucioneve tjera relevante në mbështetjen e tyre.

Në pyetjen se me resurset aktuale financiare edhe sa mendoni se mund ta përballoni gjendjen aktuale si pasojë e pandemisë, 62% apo afër 2/3 e tyre vlerësojnë se nuk mund ta kalojnë as edhe 1 muaj më shumë këtë gjendje në aspektin financiar, ndërsa 33% apo saktësisht 1/3 e tyre vlerësojnë se mund ta përballojnë 1 deri në 2 muaj. Vetëm 5% e tyre vlerësojnë se mund ta përballojnë këtë gjendje më shumë se 2 muaj.

Figura 5.6. Përbalimi i kësaj gjendje financiarisht



Për më tepër, në pyetjen e hapur se cilat janë sugjerimet apo rekomandimet e tyre për APRK-në apo institucionet e tjera relevante afër gjysma e tyre theksojnë që sigurimi i një punësimi stabil, rritja e asistencës sociale, dhe sigurimi i ushqimit për ta janë tri nevojat kryesore që ata i prioritetizojnë.

4. Konkluzione

Ky raport hulumtues i kryer në terren dhe i mbështetur nga hulumtime e raporte të tjera pasqyron gjendjen dhe nivelin e ndikimit të pandemisë tek komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian në aspektin socio-ekonomik, duke përfshirë fushat e edukimit, punësimit, mirëqenies dhe shëndetit.

Ndonëse korniza ligjore dhe institucionale e Kosovës për mbrojtjen, promovimin e të drejtave dhe integrimin në shoqëri të komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian si dhe të komuniteteve tjera pakicë është e përshtatshme; në përgjithësi këto komunitete ende janë mbrapa mesatares të indikatorëve socio-ekonomik në krahasim me popullsinë totale në Kosovë.

Ndikimi i pandemisë, i cili është duke u përshkallëzuar edhe më shumë, tek këto komunitete edhe pse është në proporcion të njëjtë me të gjitha komunitetet tjera vlerësohet që të ketë pasoja shumëfish më të mëdha duke e pasur bazën ekonomike dhe sociale më të ulët.

Në aspektin e përgjithshëm të të hyrave, familjet e komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptiane jetojnë me mesatarisht 167 Euro në muaj, apo 23.85 Euro në muaj për anëtar të familjes ose 0.79 Euro në ditë. Këto shifra si dhe struktura e burimeve të të hyrave shfaqin qartë nivelin e varfërisë që këto komunitet jetojnë në Kosovë.

Në aspektin shëndetësor, mbajtja e distancës tek këto komunitete vlerësohet si pothuajse e pamundur si pasojë e traditës dhe jetesës në bashkësi të mëdha familjare. Rrjedhimisht, një i infektuar mund të infektojë shumë më shumë persona në mungesë të hapësirave për vet-izolim.

Gjetjet nga këto hulumtime kanë treguar se gjetje të ngjashme janë për të tre komunitetet dhe për të gjitha komunat. Sidoqoftë, dallime të konsiderueshme u vunë re kur krahasoheshin midis gjinisë dhe vendit të jetesës (vendndodhje të tilla si: rurale, gjysmë-urbane dhe urbane), ku gratë dhe ata që jetojnë në zona rurale dhe gjysmë-urbane janë më të pa favorizuara për shkak të detyrimeve familjare të moshës së hershme, përkatësisht për shkak të mungesës së mundësive në ato zona, dhe në përgjithësi për shkak të nivelit më të lartë të diskriminimit.

Hulumtimi tregon se 62% e tyre janë të papunë, 8-9% prej të cilëve janë të papunë si pasojë e pandemisë. Vetëm 8% janë të punësuar, dhe 30% e tyre janë të vet-punësuar nga të cilët shumica janë në sektorin e ekonomisë jo formale. Puna apo vet-punësimi që ata e kanë, hyn kryesisht në sektorin e punëve fizike (ndërtimtari, mirëmbajtje, apo grumbullues të metaleve dhe elementeve të tjera). Kjo na lë të kuptojmë se ata kryesisht kryejnë punë të pa kualifikueshme dhe në terren.

Edhe pse 84% e të gjithë të papunëve janë të papunë afatgjatë, vetëm 40% e numrit total të të papunëve janë të regjistruar si të papunë në Zyrat e Punësimit (APRK). Numri i të regjistruarve si të papunë apo punëkërkues është rritur për 20% gjatë pandemisë.

Mungesa e eksperiencës dhe e shkathtësive në hulumtimin dhe aplikimin për punë, si dhe ndjenja e tyre si të pabarabartë vlerësohen të jenë arsye kryesore se shumë prej tyre edhe kanë humbur interesimin apo shpresën për të gjetur një vend pune.

Niveli i edukimit (formal dhe jo formal) i këtyre komuniteteve, edhe pse shumë i ulët, mësimi në distancë gjatë fund-vitit të kaluar shkollor, ua ka bërë të pamundur vijimin e mësimave në këtë formë si pasojë e mungesës së pajisjeve teknologjike.

Që nga fillimi e deri më tani, me qëllim të përballjes me pandeminë, Qeveria e Kosovës e ka ofruar vetëm një pako emergjente financiare në vlerë rreth 180 milionë Euro të shpërndara në 15 masa të cilat mbulojnë të punësuarit, të papunët, ndërmarrjet private dhe ato publike, komunat, si dhe një masë veçanërisht të adresuar për komunitetet jo-shumicë (Masa 9 – Mbështetja e iniciativave dhe projekteve të komuniteteve jo-shumicë të prekura nga COVID-19, në vlerë prej 2 milionë Euro). Nga

të gjitha këto masa, numri i përfituesve të këtyre komuniteteve është shumë i vogël në krahasim me mesataren e komuniteteve tjera në Kosovë.

Në fushën e qasjes në shërbimet shëndetësore, ndonëse shumica e tyre përdorin shërbimet publike shëndetësore, më shumë se gjysma e të anketuarve i vlerësojnë pozitivisht sa i përket qasjes dhe performancës së shërbimeve të marra. Kur jemi tek aspekti shëndetësor, pandemia domosdoshmërisht i ka prekur edhe këto komunitete në numër pothuajse proporcional me komunitetet tjera në Kosovë. Për më tepër, hulumtimi tregon se pandemia dhe karantina ka ndikuar në shëndetin emocional, mental dhe në atë fizik. Përderisa kur është fjala tek acarimet dhe dhuna në familje si pasojë e pandemisë, vetëm një numër i vogël (10-13%) pohojnë se besojnë që ka ndikuar duke shtuar se kjo mund të mos pranohet publikisht, mirëpo ka raste të shumta të acarimeve familjare që qojnë edhe në dhunë e cila në të shumtën e rasteve nuk raportohet.

Në përfundim, hulumtimi nxjerrë se 62% e këtyre komuniteteve mendojnë se nuk do mund ta përballojnë financiarisht më shumë se 1 muaj këtë gjendje të pandemisë, dhe 33% e tyre vlerësojnë se nuk mund ta përballojnë më shumë se 2 muaj.

5. Rekomandime

Rekomandimet urgjente në lidhje me pandeminë:

- Shpërndarja e pakove ushqimore dhe higjienike duke përfshirë maska dhe dezinfektues, përgjatë pandemisë në baza periodike (javore) tek rastet ekstreme socio-ekonomike të komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian nga institucionet e nivelit lokal dhe atij qendror;
- Monitorimi dhe ofrimi i sigurisë dhe shërbimeve shëndetësore në vendbanimet e tyre.

Rekomandimet në lidhje me mbështetjen e komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian në integrimin në tregun e punës:

- Vlerësimi i detajueshëm i rezultateve dhe ri-planifikimi i implementimit të kornizave ligjore në lidhje me aplikimin e kuotave rreth punësimit të komuniteteve jo shumicë në institucionet publike – qendrore dhe lokale;
- Aftësimi i tyre në shkathtësi të buta nga organizata apo institucione nëpërmjet programeve dhe projekteve të dizajnuara për nevojat e tyre me qëllim të mbështetjes në punësim dhe vet punësim të qëndrueshëm dhe formal;
- Promovimi më direkt rreth masave aktive të tregut të punës nga Agjencia e Punësimit e Republikës së Kosovës, nëpërmjet përfaqësuesve lokal të këtyre komuniteteve;
- Krijimi i masave të përshtatshme nga APRK dhe institucionet tjera përkatëse për mbështetjen e të punësuarve dhe të vet punësuarve në sektorin jo formal me qëllim të konvertimit të tyre në ekonominë formale;
- Për të pasur një integrim të ekuilibruar socio-ekonomik, në aspektin gjinor, për çdo masë ose program rekomandohet të përfshihen subvencione për kujdesin për fëmijët në mënyrë që t'u mundësohet grave të jenë pjesë e këtyre masave ose programeve në një numër të kënaqur.
- Ristrukturimi dhe / apo subvencionimi i obligimeve mujore financiare të vonuara në pagesa të shërbimeve bazike (rryma, uji, mbeturinat) për rastet e rënda nga Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale – MPMS dhe dikasteret tjerë përkatës.

Bibliografia

Admovere. 2020. Sfidat e komunitetit rom, ashkali dhe egjiptian në Kosovë gjatë pandemisë COVID-19. I qasshëm në:

http://admovere.org/wp-content/uploads/2020/07/Final_-Sfidat-e-komunitetit-rom-ashkali-dhe-egjiptian-ne-kosove-gjate-pandemise-COVID-19-Alb-.pdf.

Agjencia e Punësimit e Republikës së Kosovës. 15 Nëntor 2019. Puna dhe Punësimi në Kosovë 2019. I qasshëm në:

<https://apr.k.rks-gov.net/sq-AL/Content/Documents?doctype=2&page=4>.

Agjencia e Punësimit e Republikës së Kosovës. Data baza e Sistemit Informativ të Menaxhimit të Punësimit.

Agjencia e Statistikave të Kosovës. 2013. Vlerësimi i Popullsisë së Kosovës 2011. I qasshëm në:

<https://ask.rks-gov.net/media/2129/estimation-of-kosovo-population-2011.pdf>.

Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, MASHt. 2016. Urdhëresë Administrative, UA Nr.09.2016. Aplikimi i masave afirmative dhe vendeve të rezervuara për regjistrim të kandidatëve nga komunitetet joshumicë në institucionet publike të arsimit të lartë. I qasshëm në:

<https://masht.rks-gov.net/uploads/2016/06/ua-masht-09-2016-aplikimi-i-masave-afirmative-dhe-vendeve-te-rez-al.pdf>.

Ministria e Financave e Republikës së Kosovës, MF. Masat e Pakos Emergjente. 2020. I qasshëm në:

<https://mf.rks-gov.net/desk/inc/media/8810F09D-B3C7-4E09-9BD1-0E2B0B2AF5CB.pdf>

Programi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillim, UNDP. 30 Maj 2016. Pulsi Publik 11. I qasshëm në:

https://www.ks.undp.org/content/kosovo/en/home/library/democratic_governance/public-pulse-11.html.

Programi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillim, UNDP. 10 Janar 2014. Raporti i Zhvillimit Njerëzor 2010. I qasshëm në:

<http://hdr.undp.org/en/content/kosovo-human-development-report-2010>.

Zyra për Qeverisje të Mirë, Zyra e Kryeministrit, Qeveria e Kosovës. Prill 2017. Strategjia për përfshirjen e komuniteteve rom dhe ashkali në shoqërinë kosovare 2017-2021. I qasshëm në:

https://kryeministri-ks.net/wp-content/uploads/docs/ALB-STRATEGJIA_PER_PERFSHIRJEN_E_KOMUNITETEVE_ROM_DHE_ASHKALI_NE_SHOQERINE_KOSOVARE_2017-2021.pdf.

Shtojca A – Numri i romëve, ashkalive dhe egjiptianëve sipas komunave

Komuna	Rom		Ashkali		Egjiptian		Numri i përgjithshëm i këtyre komuniteteve sipas komunës
	Nr.	%	Nr.	%	Nr.	%	
Deçan	33	0.1	42	0.1	393	1	468
Dragash	3	0	4	0	3	0	10
Ferizaj	204	0.2	3629	3.3	24	0	3857
Fushë Kosovë	436	1.3	3230	9.3	282	0.8	3948
Gjakovë	738	0.8	613	0.6	5117	5.4	6468
Gjilan	361	0.4	15	0	1	0	377
Glllogoc	0	0	0	0	2	0	2
Graçanicë	745	7	104	1	3	0	852
Hani i Elezit	0	0	0	0	0	0	0
Istog	39	0.1	111	0.3	1544	3.9	1694
Junik	0	0	0	0	0	0	0
Kaçanik	5	0	1	0	0	0	6
Kamenicë	240	0.7	0	0	0	0	240
Klinë	78	0.2	85	0.2	934	2.4	1097
Klllokot	9	0.4	0	0	0	0	9
Lipjan	342	0.6	1812	3.1	4	0	2158
Malishevë	26	0	5	0	0	0	31
Mamushë	39	0.7	12	0.2	0	0	51
Mitrovicë	528	0.7	647	0.9	6	0	1181
Novobërdë	63	0.9	3	0	0	0	66
Obiliq	661	3.1	578	2.7	27	0.1	1266
Partesh	0	0	0	0	0	0	0
Pejë	993	1	143	0.1	2700	2.8	3836
Podujevë	74	0.1	680	0.8	2	0	756
Prishtinë	56	0	557	0.3	8	0	621
Prizren	2899	1.6	1350	0.8	168	0.1	4417
Rahovec	84	0.1	404	0.7	299	0.5	787
Ranillug	0	0	0	0	0	0	0
Shtërpçë	24	0.3	1	0	0	0	25
Shtime	23	0.1	750	2.7	0	0	773
Skenderaj	0	0	10	0	1	0	11
Suharekë	41	0.1	493	0.8	5	0	539
Viti	12	0	14	0	0	0	26
Vushtrri	68	0.1	143	0.2	1	0	212
Totali	8824	0.5	15436	0.9	11524	0.7	35784

Shtojca B – Numri i romëve, ashkalive dhe egjiptianëve të anketuar sipas komunave

Nr	Komuna	Rom	Ashkali	Egjiptian	Total të anketuarit
1	Gjakovë	71	70	109	250
2	Prizren	49	48	58	155
3	Fushë Kosovë	32	61	40	133
4	Ferizaj	38	42	21	101
5	Pejë	46	43	49	138
6	Lipjan	25	28	2	55
7	Istog	19	19	37	75
8	Obiliq	24	15	4	43
9	Mitrovicë	29	8	3	40
10	Klinë	7	2	35	44
11	Graçanicë	11	10	1	22
12	Rahovec	6	5	16	27
13	Shtime	9	8	0	17
14	Podujevë	5	13	1	19
15	Prishtinë	7	7	7	21
16	Suharekë	7	6	2	15
Total		385	385	385	1,155

“Vlerësimi i ndikimit të COVID-19 në statusin socio-ekonomik të komuniteteve Rom, Ashkali dhe Egjiptian në Kosovë”

Synimi i këtij hulumtimi është mbështetja e Agjencisë së Punësimit e Republikës së Kosovës - APRK në vlerësimin e ndikimit të COVID-19 në punësueshmërinë e grupeve të minoriteteve që jetojnë në Kosovë, përkatësisht për komunitetet Rom, Ashkali, dhe Egjiptian. Përveç kësaj, ky studim do t'i mundësojë APRK-së të rrisë efikasitetin dhe efektivitetin e strategjive që synojnë këto komunitete dhe t'i mbështesë ata që të angazhohen në tregun e punës.

Projekti financohet nga International Labour Organisation - ILO dhe është duke u implementuar nga kompania konsulente: D&D Business Support Center në bashkëpunim me APRK-në.

Informatat e dhëna në këtë pyetësor do të përdoren vetëm për qëllime të këtij projekti.

Të dhënat personale do të trajtohen në bazë të ligjit për mbrojtje të të dhënave personale

PYETËSOR

1. Informata të përgjithshme:

Komuna: _____

Vendbanimi: ☐ Urban ☐ Gjysmë urban ☐ Rural

Mosha: _____

Gjinia: ☐ M ☐ F

Etnia: ☐ Rom, ☐ Ashkali, ☐ Egjiptian

Numri i anëtarëve të familjes: _____

Profesioni apo zanati juaj: _____

2. Burimet e të hyrave

2.1. Cilat dhe sa janë burimet e të hyrave?

☐ Paga si i/e punësuar _____

☐ Asistencë sociale _____

☐ Ndonjë ndihmë tjetër qeveritare (pension invalidor, ose asistencë tjera/pension) _____

☐ Të hyra si i vetëpunësuar _____

☐ Të hyra nga biznesi _____

☐ Të hyra nga anëtarët e tjerë të familjes _____

3. Punësimi

A jeni i/e punësuar? ☐ PO ☐ I/e vetëpunësuar ☐ JO

3.1 Nëse PO, cek llojin e punësimit

- ☐ Me orar të plotë
- ☐ Me orar të përgjysmuar
- ☐ I punësuar joformal
- ☐ I punësuar përkohësisht
- ☐ Sezonal
- ☐ I punësuar afatgjatë

a.) Nëse i punësuar afatgjatë:

(i) Në çfarë moshe keni hyrë në tregun e punës? ____

(ii) Gjithsej vitet e përvojë pune? ____

(b) Nëse i punësuar afatgjatë, a keni në plan ta mbani këtë punë për afatgjatë?

☐ PO ☐ Dua ta ndërroj ☐ Dua të pauzoj ☐ Dua ta hap biznesin tim

Në cilin sektor _____ ☐ Privat ☐ Publik ☐ OJQ

3.2. Nëse i/e vetëpunësuar:

Në cilin sektor? _____

- ☐ Sezonal formal ☐ të rregullt formal
- ☐ Sezonal jo-formal ☐ të rregullt jo-formal

3.3. Nëse jeni i papunë, a jeni i regjistruar në Zyrën e Punësimit si punëkërkues? ☐ PO ☐ JO

Nëse po, kur jeni regjistruar?

☐ Para COVID-19 ☐ Pas COVID-19

Nëse jo, pse nuk jeni regjistruar?

A jeni:

- ☐ I papunë afatgjatë (më se 12 muaj), që nga ____
- ☐ I papunë (më pak se 12 muaj), që nga ____
- ☐ I papunë për shkak të pandemisë
- ☐ Pjesë e Personave me Aftësi të Kufizuara (PAK)
- ☐ Pjesë e Personave me Pengesa Shëndetësore (PPSH)

A jeni i interesuar për të gjetur punë? PO ☐ JO ☐

Nëse po, sa herë keni aplikuar për punë gjatë muajit të kaluar? _____

Nëse po, sa herë keni aplikuar për punë në gjashtë (6) muajt e kaluar? _____

Për sa nga këto aplikime për punë jeni intervistuar? _____

Si hulumtoni/ kërkoni për punë?

☐ Rrjete Sociale ☐ Gazeta ☐ Zyrat e punësimit ☐ Portale të punës

☐ Rrjeti i shoqërisë & familjes

Si aplikoni për punë?

☐ Online ☐ Fizikisht në kompani ☐ Përmes referimeve ☐ Tjetër: _____

Në një shkallë nga 1 në 5 (ku 1 është “shumë i sigurt”, dhe 5 duke qenë “aspak i sigurt”, sa i sigurt jeni në të gjitha fazat e aplikimit për punë?

CV: ☐ 1 ☐ 2 ☐ 3 ☐ 4 ☐ 5

Letra motivuese: ☐ 1 ☐ 2 ☐ 3 ☐ 4 ☐ 5

Intervista: ☐ 1 ☐ 2 ☐ 3 ☐ 4 ☐ 5

Nëse jeni duke kërkuar punë, cila besoni se është arsyeja e të qenit i/e papunë? (Zgjedh më shumë se një, nëse nevojitet)

☐ Mungesa e shkathtësive

☐ Diskriminimi

☐ Mungesa e eksperiencës

☐ Dekurajim nga familja

☐ Obligimet për përkujdesje të familjes

☐ Mungesa e motivimit

☐ Të hyra të mjaftueshme nga burime të tjera

☐ Tjetër: _____

3.4. A keni marrë ndonjëherë ndonjë mbështetje nga Zyra e Punësimit (APRK)?

☐ Po, në të kaluarën

☐ Po, momentalisht

☐ Jo

A jeni përfitues të Masave Aktive të Tregut të Punës nga MPMS/ Agjencia e Punësimit të Republikës së Kosovës (APRK):

Këshillime	PO ☐	JO ☐
Praktikë në Punë	PO ☐	JO ☐
Trajnim në Punë	PO ☐	JO ☐
Subvencionim	PO ☐	JO ☐
Aftësim Profesional (QAP)	PO ☐	JO ☐
Vet-Punësim (Ndërmarrësi)	PO ☐	JO ☐

Në një shkallë nga 1 në 5 (ku 1 është “shkëlqyeshëm”, dhe 5 duke qenë “shumë keq”), ju lutemi vlerësoni përshtypjen/perceptimin tuaj ndaj masave të mëposhtme?

Këshillime	☐ 1	☐ 2	☐ 3	☐ 4	☐ 5
Praktikë në Punë	☐ 1	☐ 2	☐ 3	☐ 4	☐ 5
Trajnim në Punë	☐ 1	☐ 2	☐ 3	☐ 4	☐ 5
Subvencionim	☐ 1	☐ 2	☐ 3	☐ 4	☐ 5
Aftësim Profesional (QAP)	☐ 1	☐ 2	☐ 3	☐ 4	☐ 5
Vet-Punësim (Ndërmarrësi)	☐ 1	☐ 2	☐ 3	☐ 4	☐ 5

4. Edukimi

4.1. Cilat nivele të edukimit formal i keni të përfunduara?

- ☐ Arsim fillor ☐ Arsim i mesëm ☐ Arsim i lartë ☐ Arsim pas-universitar
☐ Pa arsim zyrtar

Çfarë niveli të arsimit zyrtar kanë ndjekur/marrë anëtarët e familjes tuaj?

- ☐ Arsim fillor ☐ Arsim i mesëm ☐ Arsim i lartë ☐ Arsim pas-universitar
☐ Pa arsim zyrtar

4.2. A keni ndjekur ndonjë trajnim profesional? ☐ PO ☐ JO

Nëse po:

1. Ku i keni ndjekur? ☐ QAP ☐ Ofrues të tjerë: _____

2. Në cilën fushë? _____

4.3. Në planin tuaj të së ardhmes, a përfshihet vazhdimi në arsim/edukim ☐ PO ☐ JO

Nëse po, si?

- ☐ Arsim Formal
☐ Trajtime Profesionale
☐ Aftësi teknike/ zanate të marra nga kanalet jo-formale

5. Ndikimi i pandemisë në aktivitetin shoqëror

Cili është ndikimi i pandemisë në aktivitetin shoqëror?

- ☐ Lëvizja e limituar
- ☐ Limitimi i hapësirave publike dhe rekreative
- ☐ Ndalimi i tubimeve/ vizitave familjare dhe apo shoqërore
- ☐ Tjera _____

6. Ndikimi i pandemisë në aktivitetin ekonomik

Cili është ndikimi i pandemisë në aktivitetin ekonomik?

6.1. Për të punësuarit

- ☐ Largimi nga puna
- ☐ Shkurtimi i orarit të punës
- ☐ Pauzimi i përkohshëm i detyrueshëm i punës
- ☐ Pandemia nuk ka ndikuar në punën time

i. Në çfarë forme e merrni pagën? ☐ Kesh ☐ Nëpërmjet llogarisë bankare

ii. A ju është ndryshuar paga gjatë pandemisë? ☐ Po, është zvogëluar ☐ JO ☐ Po, është rritur

iii. A jeni përfitues të Masave të Pakos Emergjente Fiskale nga Qeveria/ Ministria e Financave:

Masa 3. A. (pagesa prej 170 Euro) ☐ PO ☐ JO ☐

Masa 6 (paga shtesë prej 300 Euro për punëtorët e ekspozuar në terren) ☐ PO ☐ JO ☐

Masa 7 (paga shtesë prej 100 Euro për punëtorët e dyqaneve/ furrave/ barnatoreve) ☐ PO ☐ JO ☐

6.2. Për të papunët

i. A keni qenë më herët përfitues i ndonjë asistence sociale? ☐ PO ☐ JO

Nëse Po, çfarë asistence sociale? _____

ii. A jeni përfitues të Masave të Pakos Emergjente Fiskale nga Qeveria/ Ministria e Financave:

Masa 1 (pagesë e dyfishtë për përfituesit e asistencës sociale) ☐ PO ☐ JO

Masa 2 (pagesë shtesë prej 30 Euro për përfituesit e ndihmave sociale/ pensionale) ☐ PO ☐ JO

Masa 8 (pagesë e asistencës mujore prej 130 Euro për ata që humbin vendin e punës) ☐ PO ☐ JO

Masa 15 (pagesë e asistencës mujore prej 130 Euro për të papunët që nuk janë përfitues të ndonjë skeme tjetër sociale) ☐ PO ☐ JO

6.3. Për të vetëpunësuarit dhe/apo punëdhënësit?

i. Në cilin sektor është biznesi juaj? _____

ii. Si operon biznesi momentalisht, si pasojë e pandemisë?

- | | | |
|---------------------------------|---|---|
| ☐ Njëjtë | ☐ Mbyllur | ☐ Mbyllur përkohësisht |
| ☐ Njëjtë | ☐ Reduktim të stafit | ☐ Ngritje të stafit |
| ☐ Njëjtë | ☐ Zvogëlim të orarit | ☐ Ngritje të orarit |
| ☐ Njëjtë | ☐ Ulje të të hyrave | ☐ Ngritje të të hyrave |
| ☐ Njëjtë | ☐ Zvogëlim të pagës | ☐ Ngritje të pagës |

iii. A jeni përfitues të Masave të Pakos Emergjente Fiskale nga Qeveria/ Ministria e Financave:

Masa 3.A (subvencionimi i pagës prej 170 Euro) ☐ PO ☐ JO

Masa 3.B (subvencionimi i qerasë deri në 50%) ☐ PO ☐ JO

Masa 10 A. dhe B. (sigurimi i likuiditetit financiar nëpërmes kredimarrjes) ☐ PO ☐ JO

Masa 14 (mbështetje financiare prej 130 euro në muaj për bizneset që regjistrojnë punëtorët me kontratë pune së paku 1 vjeçare) ☐ PO ☐ JO

6.4. Si ja dilni me obligimet e mëposhtme financiare mujore:

Rryma	☐ Paguaj me rregull	☐ Jam vonë me pagesa	☐ Jam liruar nga pagesa
Mbeturinat	☐ Paguaj me rregull	☐ Jam vonë me pagesa	☐ Jam liruar nga pagesa
Uji	☐ Paguaj me rregull	☐ Jam vonë me pagesa	☐ Jam liruar nga pagesa
Kreditë	☐ Paguaj me rregull	☐ Jam vonë me pagesa	☐ Nuk kam kredi
Qeraja	☐ Paguaj me rregull	☐ Jam vonë me pagesa	☐ Nuk kam qera

6.5.A keni qenë përfitues të ndonjërës nga pakot emergjente – ushqimore dhe higjienike? ☐ PO ☐ JO

Nëse Po,

Çfarë lloji të pakos? ☐ Ushqimore ☐ Higjienike ☐ Të dyja

Nga kush? _____

7. Qasja në shërbimet shëndetësore

7.1. Cilat shërbime shëndetësore i përdorni?

☐ Publike ☐ Private ☐ Nuk përdor asnjë shërbim shëndetësore

7.2. Sa shpesh ju keni nevojë për shërbime shëndetësore?

Një herë në: ☐ javë ☐ muaj ☐ gjashtëmuaj ☐ Tjetër _____

Sa janë të qasshme ofruesit e shërbimeve shëndetësore? Në një shkallë nga 1 në 5 (ku 1 është “Shumë të qasshëm”, dhe 5 duke qenë “Aspak të qasshëm”)

☐ 1 ☐ 2 ☐ 3 ☐ 4 ☐ 5

Si e vlerësoni performancën e shërbimeve shëndetësore që ju i pranoni? Në një shkallë nga 1 deri në 5 (ku 1 është “shkëlqyeshëm”, dhe 5 duke qenë “aspak mirë”)

☐ 1 ☐ 2 ☐ 3 ☐ 4 ☐ 5

8. Ndikimi psikik nga pandemia

8.1. Sa ka ndikuar pandemia në nivelin e stresit tuaj? Në një shkallë nga 1 deri në 5 (ku 1 është “shumë ndikim”, dhe 5 duke qenë “aspak ndikim”)

☐ 1 ☐ 2 ☐ 3 ☐ 4 ☐ 5

8.2. Sa ka ndikuar limitimi i aktiviteteve fizike në shëndetin e juaj mental, emocional dhe fizik? Në një shkallë nga 1 deri në 5 vlerësoni secilin (ku 1 është “shumë ndikim”, dhe 5 duke qenë “aspak ndikim”)

Shëndeti mental: ☐ 1 ☐ 2 ☐ 3 ☐ 4 ☐ 5

Shëndeti emocional: ☐ 1 ☐ 2 ☐ 3 ☐ 4 ☐ 5

Shëndeti fizik: ☐ 1 ☐ 2 ☐ 3 ☐ 4 ☐ 5

8.3. A mendoni se pandemia në përgjithësi ka ndikuar në acarime të marrëdhënieve familjare të cilat mund të qojnë edhe në dhunë? ☐ PO ☐ JO ☐ Nuk e di

Koment: _____

8.4. A mendoni se karantina përgjithësisht ka ndikuar në acarime të marrëdhënieve familjare të cilat mund të qojnë edhe në dhunë? ☐ PO ☐ JO ☐ Nuk e di

Koment: _____

Nëse po (në pyetjen C dhe/apo D)

A keni dëgjuar për ndonjë rast të dhunës në familje si rezultat i pandemisë në komunitetin tuaj?

☐ PO ☐ JO

Sa e përhapur është kjo dukuri në komunitetin tuaj? Në një shkallë nga 1 deri në 5 (ku 1 është “shumë e përhapur”, dhe 5 duke qenë “aspak e përhapur”)

☐ 1 ☐ 2 ☐ 3 ☐ 4 ☐ 5

A keni ndonjë koment në lidhje me këtë/këto raste? _____

8.5. A keni informata se ku duhet të raportohet dhuna në familje? ☐ PO ☐ JO

Nëse po, cek adresat e duhura:

☐ Policia

☐ Thirrja pa pagesë për konsulta/ mbështetje psikologjike

☐ Tjetër: _____

9. Rastet e Infektimit me COVID-19

A keni qenë ju apo dikush nga familjarë tuaj të infektuar me virusin COVID-19?

☐ PO ☐ JO ☐ Familjar

Nëse po:

Si jeni/ janë trajtuar?

☐ Në shtëpi

☐ QKUK apo ndonjë spital tjetër publik

☐ Spital privat

A keni pasur mbështetje financiare për të mbuluar kostot, nëse ka pasur? ☐ PO ☐ JO

Nëse po, nga kush? _____

A ka ndikuar kjo të largoheni nga puna? ☐ PO ☐ JO

10. Përballimi i pandemisë COVID-19

Me resurset aktuale financiare edhe sa mendoni se mund ta përballoni gjendjen aktuale si pasojë e pandemisë?

☐ Më pak se 1 muaj

☐ 1 -2 muaj

☐ Më shumë se 2 muaj

11. A keni ndonjë rekomandim konkret për Agjencinë e Punësimit të Republikës së Kosovës (Zyra e Punësimit/ QAP-at, etj.) në mbështetje të komunitetit tuaj në tregun e punës gjatë dhe pas pandemisë?

Faleminderit për kohën që ndatë për plotësimin e këtij pyetësori!